



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 13 AKTI

NR. 47 VENDIMI

Tiranë, më 25.07.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Roland Ilia	Anëtar
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ina Serjanaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia LHE Roessingh-Bakels, më datë 23.07.2018, ora 09:00, në Pallatin e Kongreseve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Astrit Faqolli**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë “Kushtetuta”);
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë “Ligji nr. 84/2016”);
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tria kriteret, vlerësimin

pasuror, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë se ka kandiduar për Këshillin e Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 30.11.2017 në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (referuar më poshtë “Komisioni”).

Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë, pasi janë caktuar me short trupat gjykues të Komisionit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete, më datë 30.11.2017.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 13.12.2017 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Firdes Shuli, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e këtij trupi, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Astrit Faqolli. Me vendimin nr. 29, datë 23.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u vendos rishpërndarja e çështjeve të shortuara në datën 30.11.2017 me relatore znj. Alma Faskaj, për shkak të mungesës së komisioneres për një afat të pacaktuar, për arsye shëndetësore. Me shortin e hedhur në datën 23.05.2018 u caktua si relatore znj. Genta Tafa (Bungo), e cila deklaroi menjëherë mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori, me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. 121/32 prot., datë 09.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit për subjektin e rivlerësimit ka konstatuar se:

- 1) *Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- 2) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- 4) *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- 5) *Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, të DSIK-së, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 23.04.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, Astrit Hysen Faqolli.*

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. 2969/3 prot., datë 22.01.2018.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 05.07.2018 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua më datë 06.07.2018 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më datë 09.07.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 16.07.2018.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht më datë 17.07.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 23.07.2018, ora 9:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Kongreseve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia LHE Roessingh-Bakels.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit i shoqëruar me përfaqësuesin e tij, avokat Julian Mërtiri, me numër licence 3341. Ai parashtroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Astrit Faqolli ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve

dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit Nr. 2/2017^[1] të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- dh) Deklarimet e personave të tjerë të lidhur.

Në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 30.01.2017, subjekti deklaroi këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

1. Truall me sipërfaqe 32 m², me adresë Librazhd, blerë sipas kontratës nr.***, datë 30.07.2003, në shumën 150.000 lekë. Mbi këtë truall është ndërtuar objekt bodrum një kat + lokal një kat + banesë një kat, në vlerën totale 2.786.720 lekë, ndërtuar sipas lejes së ndërtimit datë 21.03.2011 dhe kontratës së sipërmarrjes nr.***, datë 30.03.2011.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”:

- *Të ardhura familjare ndër vite;*

[1] “41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultonte në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- *Hua në shumën 1.000.000 lekë nga shtetasi L. Rr., sipas deklaratës noteriale nr.***, datë 20.03.2012, shumë e cila është shlyer sipas deklaratës noteriale nr.***, datë 24.10.2016, me burim nga të ardhurat familjare.*

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë shitblerjeje, nr. ***, datë 30.07.2003, për blerjen e truallit me sipërfaqe 32 m², në vlerën 150.000 lekë.
- Certifikatë pronësie, nr.331339, harta treguese për asetin truall me sipërfaqe 32 m² në emër të Astrit Faqollit.
- Kontratë sipërmarrjeje, nr.***, datë 30.03.2011, me shoqërinë “***” sh.p.k., për ndërtimin e objektit godinë banimi dhe shërbimi me sipërfaqe 30 m² kati dhe sip. totale 100 m² dhe praktikën bashkëlidhur.
- Kthim përgjigjeje drejtuar subjektit të rivlerësimit nga Bashkia Librazhd, shkresë nr.*** prot., datë 25.10.2016, kopje të dokumentacionit të kërkuar me shkresën nr.***, datë 21.10.2016.
- Faturë tatimore nr.***, datë 30.07.2011, në vlerën 2.351.937 lekë.
- Faturë tatimore nr.***, datë 30.10.2011, në vlerën 434.924 lekë.
- Mandat arkëtimi nr. ***, datë 03.09.2011, i cili konfirmon shumën 2.352.000 lekë arkëtuar nga subjekti i rivlerësimit për llogari të shoqërisë “***”;
- Mandat arkëtimi nr.***, datë 24.12.2011, i cili konfirmon shumën 435.000 lekë arkëtuar nga subjekti i rivlerësimit për llogari të shoqërisë “***”.
- Situacion punimesh progresiv.
- Përgjigje nr.***prot., datë 06.07.2017, e ZVRPP-së Librazhd, përcjellë me shkresën nr.***prot., datë 28.07.2017 të ZQRPP-së.
- Deklaratë nr.*** rep., nr.*** kol., datë 20.03.2012, dhënë nga shtetasi L. Sh. R., i cili ka deklaruar se në muajin gusht 2011 i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 1.000.000 lekë, pa afat dhe pa interes, që subjekti i rivlerësimit t’i përdorte për ndërtimin e objektit trekatësh në qytetin e Librazhdit.
- Deklaratë nr. *** rep., nr.*** kol., datë 24.10.2016, nëpërmjet së cilës huadhënësi L. R., ka deklaruar se subjekti i rivlerësimit e ka kthyer shumën e huas së marrë.
- Dy vërtetime debie lëshuar më datë 05.06.2018 nga Drejtoria Rajonale e OSHEE-së Elbasan.
- Ekstraktet e regjistrit elektronik të OSHEE sh.a.
- Deklaratë noteriale nr.*** rep., datë 14.02.2015.
- Deklaratë noteriale nr.*** rep., datë 14.02.2015.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 21.01.2015.
- Kontratë qiraje lokali nr.*** rep., nr. *** kol., datë 05.02.2016.
- Kontratë qiraje lokali nr. *** rep., nr.*** kol., datë 09.02.2016.
- Kontratë qiraje apartamenti nr. *** rep., nr.*** kol., datë 10.02.2016.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2017, drejtuar Bankës së Shqipërisë, bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve jobankare.
 - Shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2017, drejtuar ZVRPP-ve.
 - Shkresë nr. *** prot., datë 04.01.2018, drejtuar ZVRPP-ve.
- ZVRPP Librazhd, me shkresën nr.***prot., datë 12.01.2018, ka informuar se në emër të Astrit Faqollit rezultoi e regjistruar: Pasuria me nr.***, vol. ***, fq. *** , ZK

***, ndodhur në Librazhd, e llojit truall, me sipërfaqe trualli 32 m² dhe sipërfaqe ndërtese 32 m², 3 kate (bodrum 1 kat + lokal 1 kat + banesë 1 kat).

- Shkresë nr. *** prot., datë 19.03.2018, drejtuar OSHEE-së.
 - Me shkresën nr. ***prot., datë 04.04.2018, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nuk ka konfirmuar kontratë furnizimi për lidhje me energji elektrike për këtë pasuri.
- Shkresë nr. *** prot., datë 19.03.2018, drejtuar UKT-së.
 - Me shkresën e saj nr. ***prot., datë 11.04.2018, UKT-ja Librazhd ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit është abonent familjar dhe privat, me kontratën *** dhe kod sistemi ***, datë 27.07.2011, dhe se nuk ka detyrime pranë kësaj shoqërie.

Arsyetimi ligjor

Në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme, në pronësi të subjektit, Komisioni ka hetuar në disa drejtime:

- A. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.07.2003, ka blerë një truall në Librazhd me sipërfaqe 32 m², me çmim shitjeje 150.000 lekë, akt i cili është regjistruar në ZVRPP Librazhd, për të cilin është lëshuar certifikatë pronësie më datë 01.08.2003.

Në vitin 2011, me leje ndërtimi (Vendim i KRRT-së nr. 03, datë 21.03.2011 dhe miratim destinacioni nr. 03, datë 21.03.2011) nga ana e subjektit të rivlerësimit ka filluar ndërtimi i një objekti “bodrum+lokal+banesë”.

ZVRPP Librazhd konfirmon ekzistencën e kësaj pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit, pasuri nr. ***, zonë kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, e llojit truall, me sipërfaqe 32 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 32 m², 3kate (bodrum 1kat + lokal + banesë 1kat).

Gjatë hetimit, në kartelën e pasurisë vërehet se objekti është regjistruar me sipërfaqe 32m² për çdo kat.Në aktin e kolaudimit, në pikën I/1 “Leja e ndërtimit”, sipërfaqja totale e sheshit të ndërtimit pasqyrohet 32 m², sipërfaqja e katit përdhe 32 m² dhe ajo e katit të parë e të dytë pasqyrohet secila me sipërfaqe 32 m². Ndërsa, në pikën 10 të po këtij akti “Të dhënat kryesore të ambienteve”, kati përdhe është pasqyruar në sipërfaqen 32 m², kati i parë 48 m² dhe në pikën 11/3, kati i parë rezulton të jetë 46.7m². Gjithashtu, nga dokumentacioni (Vendimi i KRRT-së nr. 3, datë 21.03.2011, “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”) u konstatua se sipërfaqja e sheshit të ndërtimit dhe ajo e ndërtimit janë të njëjta.

Mbi këto mospërputhje, Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit.

Në përgjigjen e tij të datës 27.03.2018, subjekti ka sqaruar se ka deklaruar sipas projektit të objektit të miratuar së bashku me lejen e ndërtimit, dokument të cilin e ka depozituar së bashku me përgjigjen e dhënë.

Subjekti ka sqaruar se:“Nga kontakti që ka pasur me ZVRPP-të Librazhd dhe Bashkinë Librazhd, i është bërë me dije se ka një gabim në aktin e kolaudimit, i cili është korigjuar më pas, por nuk është dërguar nga Bashkia në Hipotekë për korigjim akti”. Për këtë fakt, subjekti ka njoftuar se me marrjen e aktit të ri të korigjuar, do ta dërgojë atë pranë Komisionit.

Subjekti sqaron se ka aplikuar, sipas ligjit, duke kërkuar koeficient maksimal të shfrytëzimit. Kjo kërkesë është vlerësuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Librazhd, që e ka pajisur subjektin me lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit, me aktet përkatëse, konkretisht leje ndërtimi me vendim të KRRT-së nr.3, datë 21.03.2011 dhe vendimi i KRRT-së nr.3, datë 21.03.2011. Sa i përket vlerësimit të bërë nga organi kompetent në këtë rast, në lidhje me koeficientin e shfrytëzimit, subjekti mendon se është bazuar në studimin urbanistik pjesor të miratuar nga vetë organi shtetëror.

Komisioni çmon se vlerësimi i koeficientit të shfrytëzimit në këtë rast është kompetencë e organit kompetent, i cili e bazon këtë miratim në studimin urbanistik. Në përputhje me deklarin e tij të datës 27.03.2018, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit certifikatën e pasurisë, lëshuar nga ZVRPP-ja Librazhd, më datë 27.04.2018, së bashku me kartelën e pasurisë.

Komisioni konstaton se në kartelën e pasurisë janë bërë korrigjimet përkatëse, të cilat pasqyrojnë regjistrimin e objektit, kati bodrum 32 m², kati përdhe 32 m² dhe kati i parë 48 m², duke vërtetuar deklarin e subjektit.

- ✓ Në analizë të përgjigjes së dhënë dhe dokumentacionit të administruar mbi dhënien e lejes së ndërtimit të objektit, nuk konstatohen parregullsi nga subjekti i rivlerësimit në mënyrën e aplikimit pranë organeve kompetente.

B. Komisioni konstatoi se objekti “bodrum+lokal+banesë” është ndërtuar nga shoqëria “***”, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.03.2011.

Në aktin e kolaudimit është vërejtur se punimet kanë filluar më datë 29.06.2011 dhe kanë përfunduar më datë 3.11.2011. Vlera e situacionit të punimeve të ndërtimit pasqyrohet në shumën 2.786.720 lekë. Për këtë ndërtesë është dhënë leja e shfrytëzimit me nr. 1699 prot., datë 09.12.2011, nga ana e Bashkisë Librazhd. Në kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë ndërtimore konstatohet se nuk është përcaktuar çmimi i shpenzuar për ndërtimin e saj.

Mbi këtë konstatim i janë kërkuar sqarime subjektit, i cili, më datë 08.06.2018, ka deklaruar:

“Është e vërtetë se në kontratë nuk është përcaktuar çmimi i sipërmarrjes, por jo se palët nuk e kanë përcaktuar një çmim të tillë. Shoqëria sipërmarrëse ka marrë përsipër të realizojë ndërtimin në përputhje me projektin e miratuar nga KRRT e Bashkisë Librazhd, ku pjesë e së cilës ka qenë dhe preventivi në të cilin janë specifikuar zërat e punimeve, njësitë, sasi të, çmimet dhe vlerat përkatëse, në total shuma 2.786.720 lekë. Pikërisht kjo shumë ka qenë dhe çmimi i dakordësuar nga palët dhe që përbën çmimin e sipërmarrjes, çmim ky që është konsideruar edhe gjatë zbatimit të kësaj kontrate, ku pikërisht kjo vlerë i është paguar nga unë shoqërisë.”

Detyrimi i subjektit ndaj shoqërisë së ndërtimit “***” përcaktohet në dy faturat tatimore të lëshuara nga kjo shoqëri, përkatësisht shuma 2.351.937 lekë, sipas faturës nr.***, të datës 30.07.2011, dhe shuma 434.924 lekë sipas faturës nr.*** të datës 30.10. 2011.

Subjekti është pyetur në lidhje me kohën e shlyerjes së këtyre faturave dhe njëkohësisht i është kërkuar depozitimi i dokumentacionit bankar, duke marrë në konsideratë dispozitat e legjislacionit tatimor, i cili nuk lejon pagesa cash mbi shumën 150.000 lekë.

Në përgjigjen e dhënë ka deklaruar se: “Fatura tatimore e shitjes nr.***, datë 30.07.2011, për vlerën 2.351.937 lekë, i është shlyer shoqërisë ndërtuese disa ditë pas lëshimit të kësaj fature,

në muajin shtator të vitit 2011. PAGESA është bërë cash në arkën e shoqërisë, kjo e vërtetuar me mandat arkëtimin nr. ***, datë 03.09.2011.

Fatura tatimore e shitjes, nr. ***, datë 30.10.2011, për vlerën 434.924 lekë, i është shlyer shoqërisë ndërtuese disa ditë mbas lëshimit të kësaj fature, në muajin dhjetor të vitit 2011. PAGESA është bërë cash në arkën e shoqërisë, kjo e vërtetuar me mandat arkëtimin nr. ***, datë 24.12.2011”.

Subjekti vuri në dispozicion të Komisionit dy mandatarkëtimet përkatëse. Referuar legjislacionit tatimor të kohës kur janë bërë pagesat e faturave si më lart dhe konkretisht nenit 59 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ligjvënësi ka përcaktuar se: “Tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, nuk mund të kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë, kur vlera e transaksionit është më e madhe se 300.000 lekë”. Në konsideratë të këtij përcaktimi ligjor rezulton që detyrimi në lidhje me pagesat në dorë u ngarkohet tatimpaguesve, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, vetëm sa u përket transaksioneve ndërmjet tyre.

Në këtë kuptim, subjekti nuk ka qenë subjekt tatimpagues, që përfshihet nën detyrimin ligjor, siç përcakton kjo dispozitë e ligjit për procedurat tatimore.

Në lidhje me ndërtimin mbi truallin prej 32 m², në Deklaratën-Vetting subjekti ka deklaruar si shpenzim shumë prej 2.786.720 lekësh, shumë që përputhet me faturat tatimore dhe mandatarkëtimet e depozituara, por Komisioni ka konstatuar se në deklaratën e pasurisë për vitin 2011 subjekti ka deklaruar shumë 3.000.000 për ndërtimin e këtij objekti. Për këtë mospërputhje ndërmjet dy deklarimeve subjektit i kaloi barra e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Në shpjegimet e tij, të paraqitura në datën 16.07.2018, subjekti ka sqaruar se:

“Lidhur me vlerën 3.000.000 lekë të deklaruar në deklaratën e interesave private periodik/vjetor 2011 për ndërtimin e objektit në Librazhd sqaroj se, përveç vlerës së preventivit, është llogaritur edhe:

- i. Taksa për ndërtime në infrastrukturë në shumë 90.285 lekë.
- ii. Taksa për studim urbanistik në shumë 30.095 lekë.
- iii. Taksa për leje shfrytëzimi në shumë 9.600 lekë.
- iv. Kontrata për shërbim ujësjellës-kanalizime nr. ***, datë 27.07.2011, dhe lidhje me rrjetin e ujësjellësit për konsumatorët familjarë datë 27.07.2011, në shumë totale 24.300 lekë.
- v. Kontrata për abonent familjar për furnizimin me energji elektrike në shumë totale 42.480 lekë.”

Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 10.07. (viti nuk lexohet) i Bashkisë Librazhd, që vërteton pagesën në shumë 90.285 lekë, si taksë për ndërtim në infrastrukturë, në funksion të ndërtimit të objektit. Ky vërtetim i referohet mandatpagesës nr. ***, datë 15.04.2011.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 10.07.2018, i Bashkisë Librazhd, që vërteton pagesën në shumë 30.095 lekë, për studimin urbanistik në fund të ndërtimit të objektit. Ky vërtetim i referohet mandatpagesës nr. 39985, datë 15.04.2011.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 10. (muaji nuk lexohet). (viti nuk lexohet) i Bashkisë Librazhd, që vërteton pagesën në shumë 9.600 lekë, për pajisjen me leje shfrytëzimi të objektit, sipas lejes së ndërtimit nr. 3, datë (nuk lexohet). Ky vërtetim i referohet mandatpagesës nr. ***, datë 09.12.2011.

- Kontratë për shërbime ujësjellës-kanalizime nr. ***, datë 27.07.2011, shoqëruar nga mandatarkëtimi datë 27.07.2011, në shumën 12.300 lekë dhe mandatarkëtimi datë 27.07.2011, në shumën 12.000 lekë. Në total, pagesa për shërbimet ujësjellës-kanalizime shkon në shumën 24.300 lekë.
- Mandat arkëtimi nr. ***, datë 12.09.2011, në shumën 18.240 lekë, me përshkrimin "Lidhje e re", bërë nga Astrit Faqolli për "CEZ Shpërndarje" (sot OSHEE).
- Mandat arkëtimi nr. ***, datë 12.09.2011, në shumën 24.240 lekë, me përshkrimin "Lidhje e re", bërë nga Astrit Faqolli për "CEZ Shpërndarje" (sot OSHEE).

Nga përlogaritja e këtyre pagesave rezulton se subjekti, përveç pagesës së bërë për "***", ka shlyer edhe detyrimet e mësipërme në shumën 196.760 lekë. Në total, subjekti ka shpenzuar për këtë objekt shumën prej 2.983.480 lekësh.

Pavarësisht se subjekti e ka justifikuar shumën e deklaruar në vitin 2011 për këtë pasuri, mbetet fakt mospërputhja e këtij deklarimi me atë të Deklaratës-Vetting. Në lidhje me këtë, Komisioni arsyeton se pika 2 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzojë/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë. Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor prej ku fillon të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore është pikërisht kjo deklaratë dhe të dhënat që ajo përmban. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të Pasurisë, dhe jo me deklarimet e mëparshme të tij. Këto deklarime, mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Konkluzioni përfundimtar i Komisionit do të duhet të nxirret nga motivi dhe sjelljet e subjektit, nga mënyra e plotësimit të Deklaratës- Vetting dhe nga të dhënat e hedhura në të. Përdorimi i deklarimeve në vite shërben për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë.

Në analizë të rezultatit hetimor të mësipërm, vlerësohet se subjekti ka qenë plotësisht i saktë në deklarimin e tij në Deklaratën-Vetting, duke pasqyruar vlerën e objektit të ndërtuar, ashtu siç edhe formulari e kërkon: *"Përshkruani hollësisht pasurinë, ...vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi..."*. Subjekti ka deklaruar në përputhje me dokumentacionin e disponuar: *"Vlera e situacionit të punimeve të ndërtimit pasqyrohet në shumën 2.786.720 lekë."* Ndërsa referuar formularit të deklarimit të vitit 2011, subjekti ka pasur detyrimin e deklarimit të shtesave dhe pakësimeve gjatë vitit kalendarik. Nëse subjekti do të kishte deklaruar këtë vlerë në vitin 2011, ai do të kishte qenë në kushtet e shkeljes së ligjit për deklarimin në atë vit, sepse bazuar në dokumentacion, ai ka pasur detyrimin të deklaronte edhe ato shpenzime që ka kryer për vënien e pronës në shfrytëzim. Këto shpenzime nuk e kanë rritur vlerën e pronës. Vlera e saj është ajo e paraqitur në situacionin e punimeve.

- ✓ Në përfundim të kësaj analize, Komisioni konstaton se subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e tij.

C. Komisioni, në lidhje me këtë pasuri, hetoi duke i kërkuar OSHEE-së informacion për kontrata të furnizimit me energji në emër të subjektit. Pasi OSHEE-ja nuk konfirmoi mbi këtë kërkim, subjektit iu kërkuar të depozitonte kontratat/kontratën e lidhjes me rrjetin e energjisë elektrike për të tria katet e godinës. Subjekti ka sqaruar se pas përfundimit të objektit dhe pas daljes së lejes së shfrytëzimit nr. *** prot., datë 09.12.2011, ka aplikuar pranë shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a., sot OSHEE sh.a., dhe ka lidhur dy kontrata më datë 28.12.2011 për furnizimin me energji elektrike. Njëra kontratë është lidhur për abonent privat dhe ka nr. ***, objekti i së cilës është furnizimi me energji elektrike i katit përdhe dhe bodrumit, ndërsa

kontrata tjetër është lidhur si abonent familjar dhe mban nr.***, ku objekt i së cilës është furnizimi me energji elektrike i katit të parë teknik (kati i dytë nga niveli 0). Subjekti vuri në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për këtë.

Komisioni, në kuadër të hetimit të zgjeruar, pyeti subjektin edhe lidhur me kohën në të cilën është arreduar godina (nëse është bërë ky lloj investimi), shpenzimet e bëra në çdo vit për këtë qëllim, si dhe kërkoi depozitimin e dokumentacionit provues. Subjekti ka deklaruar sepër godinën “bodrum + lokal + banesë”, ndodhur në Librazhd, nuk ka bërë asnjë lloj arredimi, bodrumi, lokali dhe banesa u janë dhënë të tretëve me qira të paarreduara dhe arredimi i tyre është bërë ngavetë ata sipas destinacionit të përdorimit.

- ✓ Në përfundim nuk krijohen dyshime të arsyeshme në lidhje me mënyrën e shfrytëzimit të kësaj pasurie.

D. Si burim për ndërtimin e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar huan e marrë nga z. L. R., në shumën prej 1.000.000 lekësh, në gusht 2011.

Për të verifikuar aftësinë huadhënëse në këtë shumë të z. Rr., Komisioni ka hetuar si më poshtë:

- Shkresë nr. *** prot., datë 04.01.2018, drejtuar ZVRPP-ve.

-Me shkresën nr.***prot., datë 16.01.2018, ZVRPP-ja Tiranë ka informuar mbi pasuritë e paluajtshme në emër të shtetasit L. R.

-Me shkresën nr.***prot., datë 12.01.2018, ZVRPP Librazhd ka informuar se në emër të L. Sh. R., rezulton e regjistruar pasuria nr.***, vol.***, fq.***, ZK***, e llojit arë + truall, me sip. 600 m², ndodhur në Babje.

- Shkresë nr. *** prot., datë 19.03.2018, drejtuar ISSH-së.

-Me shkresën nr. ***prot., datë 26.03.2018, ISSH/Drejtoria Rajonale Elbasan nuk ka dhënë informacion për shkak se i është nevojitur numri personal i këtij shtetasi.

-Me shkresën nr. ***prot., datë 28.03.2018, Drejtoria e Arkivit Qendror pranë ISSH-së ka kërkuar librezën e punës së këtij shtetasi me qëllim dhënien e informacionit.

- Shkresë nr. *** prot., datë 19.03.2018, drejtuar QKB-së.

-Me shkresën nr.***prot., datë 18.04.2018, QKB ka informuar se:

Shtetasi L. Sh. R., figuron i regjistruar me vendimin nr.***, datë 08.06.2005, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me NUIS (NIPT)***.

Shtetasi L. Sh. R., figuron të jetë administrator dhe zotërues i 50% të kuotave në shoqërinë “***” sh.p.k., e regjistruar pranë QKB-së më datë 17.08.2016, pajisur me NIPT***.

- Shkresë nr. *** prot., datë 19.03.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2017,drejtuar Bankës së Shqipërisë, bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve jobankare.

-Banka “Societe Generale Albania”, me shkresën e saj nr.***prot., datë 23.03.2018, ka konfirmuar transaksione në llogarinë bankare të z. R., gjatë vitit 2009.

- Shkresë nr. *** prot., datë 13.02.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Elbasan dhe Durrës.

-Me shkresat e saj nr. ***prot., datë 23.02.2018 dhe nr. ***prot., datë 12.03.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka informuar se: Nga verifikimi i bërë në sistemin informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të kësaj gjykate nuk rezulton të ketë çështje penale ose civile të regjistruara në emër të shoqërisë “***” sh.p.k., regjistruar me emrin “***” sh.p.k., të shoqërisë “***” sh.p.k., z. L. Sh. R., dhe z. E. K. B. Njëkohësisht, edhe nga kërkimi në arkivin e gjykatës, nuk ekzistojnë të dhëna mbi kërkesëpadi, kërkesa civile apo penale, si dhe vendime të dhëna nga ish-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd në emër të shoqërive apo këtyre shtetasve.

- Me shkresën e saj nr. *** prot., datë 20.02.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka konfirmuar se nuk ka të dhëna mbi kërkimin e Komisionit.

- Me shkresën e saj nr. ***prot., datë 27.02.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka depozituar disa çështje apo vendime të dhëna për këto shoqëri si dhe z. B., me cilësinë e palës ndërgjyqëse, por në asnjë rast nuk rezulton që rastet të jenë gjykuar nga subjekti i rivlerësimit.

Pasi administroi dokumentacionin e mësipërm, Komisioni vëren se në deklaratën noteriale nr. *** rep.,nr. *** kol., datë 20.03.2012, z. L. Rr., deklaroi se në muajin gusht të vitit 2011 i ka dhënë hua shumën 1.000.000 lekë subjektit të rivlerësimit me qëllim ndërtimin e një objekti trekatësh.

Bazuar në faturat e dorëzuara nga subjekti, rezultoi se ky i fundit, për ndërtimin e kësaj godine, ka paguar shumën 2.351.937 lekë, më datë 30.07.2011, dhe shumën 434.924 lekë më datë 30.10.2011.

Duke qenë se fatura me vlerën më të madhe i përket datës 30.07.2011, ndërsa huaja është deklaruar në gusht të 2011-ës, Komisionit i lindën dyshime të arsyeshme mbi nevojën për marrjen e kësaj huaje. Për këtë arsye, është kërkuar deklarimi i subjektit.

Në përgjigjen e dhënë në datën 08.06.2018, subjekti ka deklaruar duke konfirmuar se arsyeja e marrjes së huas nga shtetasi L. R., është me qëllim bërjen e pagesës së parë në favor të shoqërisë ndërtuese “***” (mandatarkëtimi nr. 39, datë 03.09.2011).

Duke qenë se në llogaritë bankare të subjektit nuk ka gjurmë të lëvrimit të kësaj huaje, subjekti është pyetur se cila është arsyeja e marrjes së huas te z. L. Rr., në *cash* dhe jo nëpërmjet sistemit bankar, duke marrë në konsideratë faktin që të dy dispononin llogari bankare.

Në përgjigjen e tij, subjekti ka deklaruar se huaja është marrë në *cash* për vetë raportet farefisnore mes tyre dhe, më kryesorja, sepse pagesën në favor të shoqërisë ndërtuese “***” do ta bënte në të njëjtën formë, pra në *cash*.

Subjekti është pyetur edhe në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. Rr., për dhënien e huas në shumën 1.000.000 lekë.

Në përgjigje, subjekti ka deklaruar: “Nga sa jam informuar nga shtetasi L. Rr., ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje, të ardhura të cilat ai i ka siguruar si emigrant në shtetin grek për periudhën 1992 - 2002. Përveç kësaj, si burim të ardhurash ky

*shtetas ka pasur edhe nga aktiviteti privat në fushën e ndërtimit si person fizik, për të cilën është regjistruar rregullisht dhe në regjistrin tregtar prej datës 08.06.2005, me NIPT ***.”*

Subjekti është mjaftuar me këtë deklaram dhe nuk ka depozituar asnjë dokument mbështetës për këtë. Por, nga hetimi i kryer nga Komisioni rezulton se banka “Societe Generale Albania” ka konfirmuar në favor të shtetasit Rr., tri arkëtime në vitin 2009 nga firma “***”, me vlera përkatësisht 1.000.000 lekë, 500.000 lekë dhe 1.000.000 lekë. Bazuar në këto të dhëna, Komisioni vlerëson se z. Rr., ka pasur aftësi huadhënese në këtë shumë.

Komisioni, gjatë hetimit për aftësitë huadhënese të z. Rr., konstatoi se në dokumentacionin që ZVRPP-ja Librazhd ka përcjellë për të konfirmuar pronësitë në emër e për llogari të shtetasit L. Sh. R., është administruar vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd i gjyqtarit Astrit Faqolli, nr.133, datë 18.04.2003, me objekt “Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin Sh. R./babai i shtetasit L. R.”, me kërkues vëllain e huadhënësit F. Sh. R. Z. R., është një prej trashëgimtarëve të trashëgimlënësit, i cili deklarohet nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën- Vetting, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, si huadhënës në shumën 1.000.000 lekë.

Në këtë rast, Komisionit i lindën dyshime për ekzistencën e konfliktit të interesit në dy këndvështrime: së pari, subjekti ka marrë hua te një individ, për trashëgiminë e babait të të cilit është shprehur me vendim gjyqësor për lëshimin e certifikatës së trashëgimisë; së dyti, ky vendim gjyqësor është dhënë në kushtet e konfliktit të interesit, sepse trashëgimlënësi dhe gjyqtari (në rastin tonë subjekti) kanë qenë në lidhje farefisnore.

Për të qartësuar situatën, fillimisht është pyetur vetë subjekti nëse ka gjykuar ndonjë çështje penale apo civile, kërkesa civile apo penale për z. L. Rr., familjen Rr., ose ndonjë anëtar të familjes Rr., apo, nëse prej huadhënësit dhe familjarëve të tij i është kërkuar ndonjëherë opinion, konsulencë ligjore rreth ndonjë çështjeje ligjore ose procedure gjyqësore apo angazhim në ndonjë mënyrë komunikimi rreth këtyre çështjeve. Subjekti është përgjigjur se nuk mban mend të ketë pasur ndonjë rast. Ai ka deklaruar se nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë marrëdhënie apo marrëveshje me huadhënësin dhe se, me anëtarët e familjes Rr., bashkëshorten dhe dy fëmijët, marrëdhëniet familjare janë të afërta. Sipas subjektit, huadhënësin e ka kushëri të dytë, konkretisht babai i subjektit të rivlerësimit dhe nëna e huadhënësit janë fëmijë tezeje dhe subjekti mban të njëjtin qëndrim si në deklaramet e tij, ashtu edhe në përgjigjet e dhëna në pyetësor.

Në këto kushte, Komisioni iu drejtua ILDKPKI-së me shkresën nr.*** prot., datë 18.06.2018, si institucioni i ngarkuar me ligj për analizën e konfliktit të interesit.

Me shkresën nr.***prot., datë 20.06.2018, ky institucion shprehet se: *“Në rastin konkret ekziston një mospërputhje e madhe kohore mes momentit të realizimit të detyrës publike nga ana e gjyqtarit Astrit Faqolli, me momentin e lindjes së “interesit privat” nga kjo marrëdhënie juridike huaje me shtetasin L. Rr., rrethanë kjo që tregon në mënyrë të qartë se në momentin e realizimit të detyrës publike nga ana e gjyqtarit në fjalë, nuk ka ekzistuar ndonjë gjendje konflikti ndërmjet detyrës së tij publike me “interesin privat” si më lart, të lindur shumë vite më pas.”*

Ndërsa në lidhje me ushtrimin e detyrës së subjektit në kushtet e konfliktit të interesit, duke u shprehur me vendim gjyqësor për lëshimin e certifikatës/dëshmisë së trashëgimisë të të afërmit të tij (gjini e afërt në vijë të tërthortë), ILDKPKI-ja shprehet se: *“Duke konsideruar se “lidhja gjinore” në kuptim të nenit 72, paragrafi i parë, pika 2, të Kodit të Procedurës Civile, përbën një “interes privat” në kuptim të nenit 5, pika 2, të ligjit nr. 9367/2005, të ndryshuar, me rezervën se ky i fundit (ligjinr. 9367/2005) është miratuar dhe ka hyrë në fuqi*

2 vjet pas rastit gjyqësor të paraqitur, ka vend të analizohet nëse ushtrimi i funksionit publik nga gjyqtari Astrit Faqolli në atë rast ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit”.

Në përfundim, pas analizës për të gjitha llojet e konfliktit të interesit, ILDKPKI konkludon se: “Nuk rezulton dhe nuk provohet që z. Astrit Faqolli, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të ketë ushtruar funksionin e vet publik në kushtet e konfliktit të interesit.”

Komisioni vlerëson se çështja gjyqësore në fjalë nuk është një mosmarrëveshje mes palëve, që ndaj në interesa të ndryshëm apo të kundërt. Ajo është një çështje që, për periudhën kur bëhet fjalë, shqyrtohej në një procedurë jo kontencioze (proces pa palë kundërshtare) dhe vendimmarrja e gjykatës, që bazohet vetëm mbi akte zyrtare, ka pasur natyrë deklarative, efekti juridik i së cilës meriton të konsiderohet, deri në provën e kundërt nga kushdo, që tërheq interesa pasurorë nga trashëgimia ligjore e trashëgimlënësit konkret. Subjekti, në cilësinë e gjyqtarit, në këtë rast, ka pasur kompetencë thelbësore në vendimmarrjen konkrete gjyqësore, por jo për sa i përket kompetencës përcaktuese, përderisa identifikimi i trashëgimtarëve ligjorë është një proces formal, që rezulton nga aktet zyrtare të gjendjes civile. Nuk rezulton që nga dhe pas kësaj vendimmarrjeje gjyqësore, mes individëve që kanë tërhequr interesa pasurorë nga trashëgimia, të kenë lindur mosmarrëveshje pikërisht për shkak të këtij vendimi gjyqësor, pra përcaktimin nëpërmjet tij të rrethit të trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësit.

Komisioni konstaton, gjithashtu, se deklarata e marrjes së huas dhe shlyerjes së saj datojnë përpara hetimit administrativ të kryer nga ky Komision.

Komisioni hetoi edhe për faktin nëse subjekti e kishte të domosdoshme marrjen e kësaj huaje.

Në tabelën më poshtë pasqyrohet gjendja financiare e subjektit gjatë vitit 2011, duke marrë në konsideratë gjendjen e likuiditetit në fillim të vitit ushtrimor.

		2011
1	GJENDJA E LIKUIDITETIT NË FILLIM	1.448.674lekë
2	TË ARDHURA	2.442.440lekë
	Të ardhura nga pagat e subjektit	1.130.392
	Të ardhura nga pagat e bashkëshortes	312.048
	Hua nga Luan Rreshka	1.000.000
3	SHPENZIME	836.477lekë
	Shpenzime jetese	642.857
	Shpenzime udhëtimi	193.620
4	PASURI	2.821.720
	Ndërtim bodrum + lokal + banesë	2.786.720
	Mobilimi i shtëpisë sipas pyetësorit	35.000
5	GJENDJA E LIKUIDITETIT NË FUND	88.188lekë
	DIFERENCA (1+2-3-4-5)	144.729lekë

Në analizë të të dhënave të kësaj table rezulton se, pavarësisht se subjekti në fund të vitit 2011 ka pasur tepriçë prej 144.729 lekësh, kjo tepriçë, si dhe investimi i kryer në këtë vit,

mund të mundësohej vetëm nëpërmjet kësaj huaje. Në këto kushte, Komisioni çmon se marrja e kësaj huaje nuk ka qenë fiktive.

Me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2016, z. L. R., deklaroi kthimin e huas nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me shlyerjen e kësaj huaje, Komisioni kreu analizën financiare për të pasqyruar gjendjen financiare të subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e kësaj huaje. (Për më tepër, referohu në analizën e bërë më poshtë për vitin 2016.)

- ✓ Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, si dhe deklarimeve të subjektit, Komisioni çmon se nuk lindin dyshime të arsyeshme për fshehje të të ardhurave apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

E. Subjekti ka deklaruar të ardhura të siguruara nga dhënia me qira e kësaj pasurie (bodrum një kat + lokal një kat + banesë).

Në Deklaratën e Pasurisë-Vetting, subjekti ka deklaruar:

Të ardhura nga qiraja sipas kontratës nr.***, datë 05.02.2016, në shumën 360.000 lekë (periudha e qirasë ka filluar më datë 01.01.2015 dhe përfundon më 30.12.2018). Tatimfitimi është paguar nga qiramarrësi.

Të ardhura nga qiraja në shumën 168.000 lekë, sipas kontratës nr.***, datë 10.02.2016, në shumën 7000 lekë në muaj (periudha e qirasë ka filluar më datë 01.01.2015 dhe përfundon më datë 30.12.2018). Tatimfitimi është paguar nga qiramarrësi.

Të ardhura nga qiraja në shumën 168.000 lekë, sipas kontratës nr.***, datë 09.02.2016, në shumën 7000 lekë/muaj (periudha e qirasë ka filluar më datë 01.01.2015 dhe përfundon më datë 30.12.2018). Tatimfitimi është paguar nga qiramarrësi.

Në deklarimin e pasurive ndër vite nga subjekti, konstatohet:

Në deklaratën e pasurisë për vitin 2014 subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 480.000 lekë nga qiraja e tri ambienteve të pasurisë së paluajtshme të ndodhura në qytetin e Librazhdit, shtetasve B. Q., L. K., dhe D. K., sipas deklaratave noteriale. Në deklaratat noteriale është deklaruar nga qiramarrësit, shtetasit B. Q., L. K., dhe D. K., se qiratë mujore ia kanë shlyer pronarit paradhënie për gjithë vitin 2014, si dhe kanë shlyer edhe 10 % të tatimfitimit të qirasë së lokalit.

Në deklaratën e pasurisë për vitin 2015, subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 348.000 lekë, nga dhënia me qira e tri ambienteve të pasurisë së paluajtshme të ndodhur në qytetin e Librazhdit, shtetasve B. Q., sipas kontratës noteriale qira apartamenti (48 m²), nr.*** rep., nr.*** kol., datë 10.02.2016; shtetas L. K., sipas kontratës noteriale qira lokali (32m²) nr.*** rep., nr.*** kol., datë 05.02.2016 dhe shtetasit D. K., sipas kontratës noteriale qira lokali (32 m²) nr.*** rep., nr. *** kol., datë 09.02.2016, të bëra para noterit publik E.B.,Librazhd, të cilët do të paguajnë edhe tatimin e fitimit mbi vlerën e qirasë.

Në deklaratën e pasurisë për vitin 2016, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiratë e pasurive të paluajtshme për vitin 2016 në shumën 348.000 lekë.

Bazuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit konsiderohen si pasuri të ligjshme të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, Komisioni hetoi rreth këtij fakti:

- Shkresë nr. *** prot., datë 13.02.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Me shkresën nr. *** prot., datë 12.04.2018, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, ndër të tjera, ka informuar se:

- Për vitin 2014, vlera prej 16.800 lekësh rezulton e paguar nga shtetasit B. Q., dhe D. K., respektivisht në shumën 8.400 lekë për deklaratat noteriale nr.*** rep., datë 14.02.2015, nr. *** rep., datë 21.01.2015.
- Për vitin 2015, vlera prej 50.400 lekësh rezulton e paguar nga shtetasit B. K., B. Q., dhe D. K., respektivisht në shumën 25.200 lekë nga B. K., dhe nga 12.600 lekë dy shtetasit e fundit.
- Për vitin 2016, vlera prej 25.200 lekësh rezulton e paguar nga shtetasit B. Q., dhe D. K., respektivisht në shumën 12.600 lekë nga secili.

Janë depozituar 7 mandatpagesa të datës 06.04.2018 të “Raiffeisen Bank”.

- Shkresë nr. *** prot., datë 26.02.2018, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Zyrës së Regjistrimit Noterial.

-Me shkresën nr. *** prot., datë 09.03.2018, Ministria e Drejtësisë ka konfirmuar disa veprime noteriale me cilësinë e blerësit dhe të klientit në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij.

- Shkresë nr. *** prot., datë 8.03.2018, drejtuar noterit publik E.B.

Me shkresën e datës 23.03.2018, noteri vë në dispozicion:

- Katër deklarata noteriale dhe tri kontrata qiraje të subjektit të rivlerësimit dhe bën me dije se regjistrin noterial nga vitet 2015 e në vazhdim nuk e disponon, ndodhet në Ministrinë e Drejtësisë.
- Një fletë regjistri që u përket regjistrimeve noteriale të vitit 2012.

- Shkresë nr. *** prot., datë 20.04.2018, drejtuar noterit publik P.P.

- Me shkresën nr. ekstra prot., datë 25.04.2018, noteri publik vë në dispozicion: Katër fletë të regjistrimit të përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale sipas kërkesës së Komisionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni ka konstatuar disa paqartësi të vërejtura në fletët e regjistrimit noterial të noterit E. B., pasi nga regjistri i noterit nuk del qartë emri i shtetasve B. Q., dhe D. K., për aktet noteriale kontratë qiraje nr.***, datë 10.02.2016, deklaratë noteriale nr.***, datë 21.01.2015 dhe deklaratë noteriale nr.*** rep., datë 14.02.2015, për të cilën në regjistër del një veprim tjetër me emër tjetër dhe datë tjetër.

Komisioni ka konstatuar se edhe në dokumentacionin e depozituar nga Zyra e Regjistrimit Noterial pranë Ministrisë së Drejtësisë, nuk rezultojnë të pasqyruara aktet noteriale të lartpërmendura, me referencë *dhënie me qira*.

Sipas dokumentacionit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, reflektuar në tabelën më poshtë, rezulton se tatimi mbi të ardhurat nga qiraja, titulluar “*Tatimi i paguar sipas mandatpagesave*”, për vitin 2014 është paguar në shumën 16.800 lekë, për vitin 2015 në shumën 50.400 lekë dhe për vitin 2016 në shumën 25.200 lekë, provuar kjo me mandatpagesat e datës 06.04.2018 lëshuar nga “Raiffeisen Bank”.

Ndërsa, “*Tatimi i paguar sipas Diva*” (referuar rubrikës me këtë titull në tabelën më poshtë), mbi të ardhurat e qirave mbetet në kuadër vetëdeklarimi nga subjekti.

VITI	TOTAL QIRA	TATIMI I LLOGARITUR	TATIMI PAGUAR SIPAS DIVA	TATIMI I PAGUAR SIPAS MANDAT-PAGESAVE	TOTALI I TATIMIT TË PAGUAR	DIFERENCA
2014	408.000	40.800	24.000	16.800	40.800	0
2015	348.000	52.200	1.800	50.400	52.200	0
2016	348.000	52.200	27.000	25.200	52.200	0

Në analizë të fakteve të mësipërme, Komisioni konstaton se subjekti ka në pronësi pasurinë e dhënë me qira që nga data 01.01.2014- 31.12.2014. Duke qenë se subjekti ka qenë subjekt i deklarimit të të ardhurave pranë ILDKPKI-së, në kuadër të deklarimit të këtyre të ardhurave për vitin 2014, ka marrë deklarimin e qiramarrësve në formë noteriale, në datën 14.02.2015. Bazuar në nenin 803 të Kodit Civil, kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë. Kjo do të thotë se për marrëdhënien e qirasë për një vit, subjekti nuk ka qenë ligjërish i detyruar për hartimin e një akti noterial, por kjo deklaratë noteriale ka qenë e domosdoshme për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave. Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan ka konfirmuar pagesën e tatimit për të ardhurat e siguruar nga qiraja. Në kushtet e ripërtëritjes së marrëdhënies së qirasë, për një periudhë trevjeçare, subjekti ka lidhur përpara noterit tri kontrata qiraje, përkatësisht për bodrum një kat + lokal një kat + banesë, për të cilat konfirmohet pagesa e tatimit.

Në lidhje me pasaktësitë në regjistrimin e veprimeve noteriale, Komisioni konstaton se bazuar në germën “a” të nenit 39 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, noteri ka si kompetencë redaktimin e akteve noteriale, ndërsa neni 70 parashikon se: “*Në çdo zyrë noteriale është e detyrueshme të mbahen: a) regjistri i përgjithshëm ku regjistrohen të gjitha aktet dhe veprimet noteriale; ...*”. Mënyra e mbajtjes së këtij regjistri, si dhe pasqyrimi i akteve noteriale në të përcaktohen nga Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë nr.6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, ndryshuar me Udhëzim nr.7203, datë 16.9.2009. Moszbatimi i kushteve të përcaktuara në këto akte ligjore e nënligjore ngarkon me përgjegjësi noterin dhe jo kërkuesin e aktit noterial (pika 24 e udhëzimit).

Komisioni konstaton se subjekti ka qenë korrekt në pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja, duke legjitimuar në këtë mënyrë burimin e tyre. Mungesa e saktësisë në dokumentacionin e hartuar nga noteri, si dhe detyrimet ligjore të pazbatuara nga ana e këtij funksionari publik, nuk mund të ngarkojnë me faj subjektin.

Në përfundim të hetimit të kryer nga ana e Komisionit, pasi administroi dhe mori në shqyrtim dokumentacionin përkatës, si dhe deklarimet e subjektit në lidhje me këtë pasuri, ndërtimin e saj, si dhe dhënien me qira, çmohet se:

- ✓ Subjekti ka aplikuar rregullisht dhe në përputhje me ligjin për pajisjen me lejen e ndërtimit.
- ✓ Subjekti ka pasur mundësi financiare për kryerjen e ndërtimit mbi truall, duke marrë huan e deklaruar.
- ✓ Subjekti nuk ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

- ✓ Subjekti ka zbatuar korrektësisht ligjin tatimor për të ligjëruar burimin e të ardhurave nga qiraja.
- ✓ Subjekti ka qenë i saktë në deklaratimet e tij në lidhje me shumën e shpenzuar për këtë pasuri.

2. Apartament banimi me sipërfaqe 83.31 m², me adresë Rr. “***”, H.***, Ap.***, Tiranë, porositur në vitin 2006 në vlerën 42.300 euro dhe formalizuar me kontratën e shitblerjes nr.***, datë 15.08.2015.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas “Deklaratës-Vetting”: *Të ardhurat familjare ndër vite.*

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “***” sh.p.k., të datës 10.01.2006.
- Kontratë shitblerjeje nr.***, datë 15.08.2015, lidhur ndërmjet Astrit Faqollit dhe shoqërisë “***” sh.p.k.
- Certifikatë pronësie nr.1167975 dhe kartelë pasurie.
- Vërtetim nr.***prot., datë 24.10.2016, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- Vërtetim, datë 06.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- Kontratë sipërmarrjeje nr.*** rep., datë 27.01.2000.
- Mandatarkëtim, datë 26.01.2000, arkëtuar nga M. H., 20.000 dollarë.
- Mandatarkëtim, datë 17.06.2000, arkëtuar nga M. H., shuma 3000 dollarë.
- Mandatarkëtim, nr.***, datë 01.08.2001, arkëtuar nga A. P., shuma 14300 USD.
- Mandatarkëtim nr.1, datë 11.12.2001, arkëtuar nga A. P., shuma 4000 USD.
- Kontratë shitjeje apartamenti nr.*** rep., nr.*** kol., datë 22.12.2000, midis shoqërisë “***” sh.p.k. dhe blerësve A. P., dhe S. H.
- Certifikatë pronësie në emër të A. P. P., dhe S. H., lëshuar më datë 07.06.2006.
- Prokurë e posaçme nr.*** rep., nr.***kol., datë 11.12.2006.
- Kontratë shitjeje pasurietë paluajtshme nr.*** rep., nr.***kol., datë 12.12.2006.
- Deklaratë noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë 08.06.2018.
- Deklaratë noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë 08.06.2018.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr.*** prot., datë 04.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë.

- Me shkresën nr.***prot, datë 31.01.2018, ZVRPP Tiranë informon se në emër të subjektit rezulton e regjistruar pasuria nr.***, lloji i pasurisë: apartament me sipërfaqe 83.31 m². Bashkëlidhur është dërguar kartela përkatëse e pasurisë, kontrata e sipërmarrjes e datës 10.01.2006, si dhe kontrata e shitblerjes nr.***, datë 15.08.2015.

- Shkresë nr.*** prot., datë 11.01.2018, drejtuar OSHEE-së.

- Me shkresën nr.***prot., datë 06.02.2018, OSHEE-ja ka informuar se: Referuar sistemit të faturimit, kontrata *** rezulton në emër të Astrit Faqollit, e cila është hapur më datë 11.04.2006 dhe se kjo kontratë nuk ka fatura të palikuiduara.

- Shkresë nr.*** prot., datë 04.01.2018, drejtuar ISSH-së.

- Me shkresën nr.***prot., datë 10.01.2018, ISSH na ka informuar se: Të dhëna për kontributet që mblidhen dhe dërgohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet *WebService*, i disponojnë nga viti 2012 e në vazhdim. Në to rezulton se subjekti Ilda Faqolli është e punësuar në kompaninë “***” dhe për të paguhen kontributet përkatëse.

- Shkresë nr. *** prot., datë 04.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

-Me shkresën nr. ***prot., datë 09.02.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka informuar:Mbi të ardhurat që ka realizuar nga punësimi znj. I. F., për periudhën dhjetor 2011 - dhjetor 2017.

-Me shkresën nr. ***prot., datë 26.02.2018, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, ndër të tjera, ka informuar: Tatimpaguesi I. F., me NIPT ***, ka kaluar në status pasiv qysh prej datës 23.06.2010 dhe për këtë shkak nuk disponohen të dhëna për qarkullimin dhe fitimin/humbjen në vite. Tatimpaguesi nuk ka detyrime në kohë reale. Nuk disponohen të dhëna mbi pasqyrat financiare dhe për kontributet e sigurimeve shoqërore të kaluara.

- Shkresë nr. *** prot., datë 04.01.2018, drejtuar QKB-së.

- Me shkresën nr. ***prot., datë 22.01.2018, QKB ka informuar se: Nga verifikimi i kryer mbi bazën e emrit, si kriter i vetëm kërkimi, rezulton se figuron i regjistruar një subjekt me emrin I. F., si person fizik, pajisur me NUIS ***, i cili nuk ka kryer plotësimin e të dhënave në QKB.

- Shkresë nr. *** prot., datë 13.02.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Elbasan dhe Durrës.

-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasanme shkresat nr. ***prot., datë 23.02.2018, dhe nr.***prot., datë 12.03.2018;Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me shkresën nr. *** prot., datë 20.02.2018, dheGjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. ***prot., datë 27.02.2018, kanë konfirmuar se:Nuk ka procese të zhvilluara nga subjekti i rivlerësimit me dhe për shoqërinë “***” sh.p.k.

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2017, drejtuar ZVRPP-ve.

- Me shkresën nr.***prot., datë 16.01.2018, ZVRPP Tiranë ka informuar se A. P., ka pasur të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë (e transkriptuar), me të dhënat: Pasuria nr.***, lloji i pasurisë apartament me sipërfaqe 135 m².

Arsyetimi ligjor

Në lidhje me këtë pasuri në pronësi të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka kryer hetim në disa drejtime:

- A. Subjekti i rivlerësimit me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2015, ka blerë apartament me sipërfaqe 83.31 m², për shumën 42.300 euro.

Ky apartament ka burimin nga kontrata e sipërmarrjes e datës 10.01.2006. Në këtë kontratë, e cila është pjesë e dokumentacionit që shoqëron pronën pranë ZVRPP-së Tiranë, sipërfaqja e apartamentit përcaktohet 94 m², së bashku me ambientet e përbashkëta.

Ndërsa në nenin 2 të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2015, përcaktohet “Apartamentin e përshkruar më sipër, së bashku me aksesoret dhe sipërfaqet e tjera në bashkëpronësi, të dy palët deklarojnë se kanë rënë dakord që shitësi ia shet blerësit kundrejt çmimit prej 42.300 eurosh. Në këtë çmim hyn dhe nënkuptohet e përfshirë dhe vlera e pjesës përkatëse të truallit, e cila do t’i kalojë blerësit në pronësi të përbashkët me bashkëpronarët e tjerë.”

Në këto kushte, rezulton se ndryshimi i sipërfaqes së apartamentit nga kontrata e sipërmarrjes të kontrata e shitblerjes vjen si pasojë e përcaktimit në pjesë të ndara të sipërfaqes individuale të banimit dhe atyre të përbashkëta.

Sipas kontratës së sipërmarrjes, pagesa do të kryhet me këste si më poshtë:

1. Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate do të paguhet shuma 15.000 euro;
2. Deri më datë 31.08.2006 do të paguhet shuma 20.000 euro;
3. Deri në dhjetor të vitit 2006 do të paguhet shuma 7.300 euro.

Këto këste janë paguar sipas mandatpagesave të vëna në dispozicion të Komisionit (shiko më poshtë).

→ Në lidhje me mundësitë financiare të subjektit për blerjen e kësaj pasurie

Në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, më 10.01.2006, subjekti ka paguar këstin e parë në shumën 15.000 euro. Nga shqyrtimi i deklarimeve ndër vite të subjektit rezulton se në vitin 2003, deklarimi për herë të parë, subjekti ka deklaruar gjendje *cash*, kursime, 5.000.000 lekë, në vitin 2004 ka deklaruar kursime *cash* 1.000.000 lekë dhe në vitin 2005 shumën 800.000 lekë.

Nga përlllogaritja e kursimeve sipas deklarimeve në këto tri vite, rezulton se subjekti nuk i kishte mundësitë financiare për të paguar as këstin e parë për këtë apartament. Në këto kushte u kërkua deklarimi i tij për të konfirmuar saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave në deklaratat e mëparshme.

Subjekti, në përgjigje të pyetjeve të Komisionit, ka deklaruar se shuma deklaruar në vitin 2003 i referohet vlerës në “të reja”, ndërsa dy shumat e tjera, përkatësisht 2004 dhe 2005, janë shprehur në “të vjetra”. Për vitet 2004 dhe 2005 subjekti ka deklaruar dhe konfirmuar këtë deklarim se shumat që ka kursyer ka qenë përkatësisht 100.000 lekë dhe 80.000 lekë.

Nga ky deklarim i subjektit lindën dyshime të arsyeshme mbi saktësinë e deklarimit të gjendjes *cash* në vitet 2003-2005. Për këtë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës. Në shpjegimet e tij të depozituara pranë Komisionit në datën 16.07.2018, subjekti rikonfirmon qëndrimin e tij, duke u shprehur se: *“Sikurse kam sqaruar dhe në pyetësorët e bërë nga Komisioni, mënyra e të shprehurit në deklaratat e interesave private periodik/vjetor 2004 dhe 2005 nuk ka qenë e duhura dhe jo e saktë në deklarimin e vlerave të likuiditeteve cash, duke i deklaruar “në lekë të vjetër”. Gjithashtu, sqaroj se ky term “lekë të vjetër dhe lekë të rinj” nuk njihet në asnjë institucion bankar apo shtetëror, por në përditshmërinë tonë zakonisht, në përgjithësi, i referohemi nocionit të “lekëve të vjetër”. Kjo ka qenë edhe arsyeja që unë, gabimisht, në deklaratat e interesave private periodik/vjetor 2004, 2005 kam shënuar vlerën e likuiditeteve sipas gjuhës së përditshme të përdorur gjerësisht.”*

Ashtu si në shpjegimet me shkrim, edhe në seancë, subjekti këmbënguli në shfajësimin e tij për shkak të përdorimit rëndom në gjuhën e përditshme të kësaj mënyre të shprehuri.

Subjekti ka deklaruar si burim krijimi të shumës së deklaruar si kursime prej 5.000.000 lekësh, të ardhurat nga bashkëshortja si person fizik me NIPT *******, për periudhën 1999-2003, si vijon:

Viti 1999, xhiro e deklaruar 2.000.000 lekë, tatim 24.600 lekë.

Viti 2000, xhiro e deklaruar 2.000.000 lekë, tatim 40.000 lekë.

Viti 2001, xhiro e deklaruar 2.000.000 lekë, tatim 40.000 lekë.

Viti 2002, xhiro e deklaruar 2.000.000 lekë, tatim 40.000 lekë.

Viti 2003, xhiro e deklaruar 1.500.000 lekë, tatim 60.000 lekë.

Bashkëshortja e subjektit ka ushtruar aktivitetin e saj privat si farmacistë, e pajisur me NIPT ***. Xhironja vjetore e këtij biznesi është vetëdeklaruar në kufirin maksimal prej 2.000.000 lekësh. Bazuar në VKM-në nr.182, datë 25.04.1995, “Për çmimet e shitjes së barnave”, të ndryshuar, në tabelën më poshtë pasqyrohen të ardhurat e mundshme nga fitimi i aktivitetit të bashkëshortes. Përlllogaritjet në këtë rast kapin marzhin maksimal të fitimit në këtë lloj aktiviteti, i cili rezulton të jetë 35 %, gjithnjë referuar kohës në të cilën ka ndodhur veprimi, pra në kohën që bashkëshortja ka ushtruar këtë aktivitet si person fizik i regjistruar në QKR. Ndërsa të ardhurat nga pagat e subjektit për periudhën 1998- 2003 janë në vlerën 2.534.262 lekë, sipas llogaritjeve nga vërtetimet e vendeve të punës.

	Xhiro në lekë	Fitim (normë fitimi 35%)	Tatimfitimi	Fitim neto
1999	2.000.000,00	700.000,00	-24.600,00	675.400,00
2000	2.000.000,00	700.000,00	-40.000,00	660.000,00
2001	2.000.000,00	700.000,00	-40.000,00	660.000,00
2002	2.000.000,00	700.000,00	-40.000,00	660.000,00
2003	1.500.000,00	525.000,00	-60.000,00	465.000,00
		Të ardhura të bashkëshortes 1999–2003		3.120.400,00
		Të ardhura të subjektit 1998- 2003		2.534.262,00
		TOTAL TË ARDHURA		5.654.662,00
		Shpenzime jetese 1998- 2002 (20.000 lekë/muaj)		1.200.000,00
		Shpenzime jetese 2003		482.143,00
		TOTAL SHPENZIME		1.682.143,00
		DIFERENCA E MUNDSHME PËR KURSIM		3.972.519,00

Sipas kësaj analize, subjekti rezulton me të ardhura të pamjaftueshme për krijimin e kursimeve në shumën 5.000.000 lekë.

Mbi këtë konstatim të Komisionit është kërkuar deklarimi i subjektit. Në përgjigjen e tij të datës 18.06.2018, subjekti ka deklaruar se mënyra e të shprehurit në deklaratën e interesave private periodik/vjetor të vitit 2006 nuk ka qenë e duhura dhe jo e saktë, pasi vlera e apartamentit është likuiduar e gjitha brenda vitit 2006 dhe për këtë është përdorur e gjithë gjendja *cash* në shumën 5.180.000 lekë. Lidhur me provueshmërinë e këtij deklarimi, subjekti ka dhënë të tjera detaje. Konkretisht ka deklaruar se ka filluar punë si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd më datë 16 nëntor 1997, detyrë të cilën e ka vazhduar deri më datë 31.08.2003. Më tej, më datë 31.07.2003 është emëruar me detyrën e inspektorit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe deri më 31.12.2003 të ardhurat totale kanë qenë në shumën 2.893.956 lekë. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se edhe bashkëshortja e tij prej vitit 1999 ka ushtruar aktivitetin privat, duke hapur farmacinë e saj. Të ardhurat në këtë rast janë siguruar nga recetat e rimbursueshme, sipas kontratës së lidhur me ISKSH-në, recetat e parimbursueshme, nga shitja e barnave me lekë në dorë, të cilat sipas rregullave të Ministrisë së Shëndetësisë nuk kishin nevojë për recetën e mjekut, si dhe nga shitja e produkteve

kozmetike, suplementeve bimore, si dhe materialeve të ndryshme dhe aksesorëve mjekësorë, të cilët përbënin një gamë të gjerë produktesh. Duke qenë se në farmaci janë shitur edhe produkte të tjera, përveç barnave, marzhi i fitimit ka qenë më i madh se 35%, mund të shkonte deri në 40%, që në përlllogaritje të thjeshtë, duke llogaritur marzhin 40% të xhiros së deklaruar në shumën totale 9.500.000 lekë, fitimi ka qenë rreth shumës 3.800.000 lekë. Subjekti, gjithashtu, ka deklaruar se deri në muajin gusht 2003 ka jetuar në qytetin e Librazhdit në banesën private të prindërve dhe se shpenzimet kanë qenë të vogla, pasi familja siguronte vetë shumë produkte ushqimore, si familje bujqësore, në shtëpinë dhe tokën që kishin aty, si dhe ndihmë kanë qenë edhe pensionet e tyre. Subjekti deklaroi se ka shpenzuar për konsum familjar për vitet 1997 - dhjetor 2003 rreth 1.500.000 lekë. Pasi ka deklaruar edhe për shpenzimet mesatare vjetore pas martesës, së bashku me bashkëshorten dhe vajzën, ka shpjeguar se shuma e deklaruar në deklaratën e pasurisë për vitin 2003, prej 5.000.000 lekësh *cash*, është e mundur të krijohet me të ardhurat e realizuara. Për blerjen e apartamentit, në shumën totale 42.300 euro, e konvertuar sipas kursit të kohës rreth 5.250.000 lekë, është përdorur e gjithë gjendja *cash* që ka pasur në banesë, nga kursimet e deklaruara në vitet 2003, 2004, 2005, në shumën totale 5.180.000 lekë.

Në përfundim të rezultateve të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar masën e fitimit nga aktiviteti “Farmaci” i bashkëshortes, përkatësisht për medikamentet mjekësore dhe për mallrat e tjera të shitura në këtë farmaci. Në shpjegimet e tij subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka rikonfirmuar të njëjtin qëndrim.

Nga analiza e këtyre fakteve, Komisioni konstaton se subjekti ka gabuar në deklarimin e kursimeve të tij për vitin 2004 dhe 2005, duke përdorur për këtë deklarim nocionin “lekë të vjetër”. Por, subjektit nuk mund t’i mohohet vërtetësia e deklarimit të kursimeve në vitin 2003 për shumën 5.000.000 lekë, duke pasur parasysh të ardhurat e siguruara nga aktiviteti i farmacisë në pronësi të bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga paga e vetë subjektit.

Komisioni vlerëson se subjekti ka gabuar, duke mos i dhënë rëndësi dhe kushtuar kujdes një dokumenti zyrtar. Në të njëjtën kohë, Komisioni arsyeton se ky gabim nuk mund të konsiderohet i qëllimshëm, përderisa nuk arrihet të vërtetohet se mund të kemi të bëjmë me fshehje të burimit të ligjshëm apo fshehje të pasurisë. Nga ana tjetër, Komisioni çmon se kemi të bëjmë me një pasaktësi në deklaratat e viteve 2004 dhe 2005, pra jo në Deklaratën-Vetting, që është dokumenti mbi të cilin bazohet rivlerësimi. Më tej, Komisioni arsyeton se kjo pasaktësi nuk lidhet me deklarimin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Nxjerrja e konkluzionit për “deklarim të pamjaftueshëm”, në lidhje me pasurinë, bëhet mbi bazën e shkakut kushtetues, kur vërtetohet se subjekti, sipas Deklaratës-Vetting, nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë, apo kur tenton të kryejë fshehje apo deklarim të rremë të pasurisë.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar të ardhurat që ka realizuar subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshorten deri në vitin 2003:

	Qarkullimi	Fitim (normë fitimi 40%)	Tatimfitimi	Fitim neto
1999	2.000.000	800.000	-24.600	775.400
2000	2.000.000	800.000	-40.000	760.000
2001	2.000.000	800.000	-40.000	760.000
2002	2.000.000	800.000	-40.000	760.000
2003	1.500.000	600.000	-60.000	540.000
		Të ardhura të bashkëshortes, 1999-2003		3.595.400

	Të ardhura të subjektit, 1998-2003	2.893.956
	TOTAL TË ARDHURA	6.489.356
	SHPENZIME JETESE, 1998-2003	1.500.000
	TOTAL SHPENZIME	1.500.000
	DIFERENCA E MUNDSHME PËR KURSIM	4.989.356

- ✓ Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit, si dhe deklarimeve të subjektit, rezulton se subjekti ka pasur mundësi për të kursyer shumën prej 5.000.000 lekësh.

- B.** Nga shqyrtimi i deklarimit ndër vite të pasurisë së subjektit, Komisioni konstatoi se në vitin 2006 ka deklaruar se për blerjen e apartamentit ka përdorur kursimet e mbledhura deri në vitin 2006 në vlerën prej 2.300.000 lekësh. Duke qenë se ky deklarim në vitin 2006 nuk përputhet as me deklarimet e mëpasshme të subjektit dhe as me llogaritjet e bëra mbi bazën e dokumentacionit të administruar, në përfundim të hetimit administrativ, subjektit iu kalua barra e provës për të sqaruar këtë fakt.

Në shpjegimet e tij, subjekti ka pretenduar se: *“Një konstatim i tillë, në fakt nuk i referohet deklarimit të bërë në formularin nr. 8 të deklaratës së interesave private periodik/vjetor 2006 të dorëzuar brenda afatit ligjor (datë 19.3.2007), por një deklaratë shtesë të bërë nga ana ime, mbasi jam thërritur në ILDKPKI më datë 06.06.2007. Deklarata shtesë e bërë nga unë në këtë rast është e pasaktë dhe nuk e kuptoj në çfarë rrethanash kam bërë një deklarim të tillë kur, në fakt, e vërteta është sipas asaj që kam deklaruar në deklaratën origjinale të pasurisë për vitin 2006. Me këtë jam duke shpjeguar se në vitin 2006 vlera e kursimeve të mia familjare ka qenë në shumën 5.180.000 lekë dhe është pakësuar po në këtë shumë. Pra, unë vetë, pavarësisht deklarimit shtesë datë 06.06.2007, në të gjitha deklarimet e mia periodike të mëvonshme kam konsideruar deklarimin e bërë në deklaratën origjinale të pasurisë të dorëzuar më datë 19.3.2007.”*

Në konkluzion, Komisioni vlerëson se në këtë rast subjekti nuk është bindës në argumentet e tij. Ai ka qenë i pasaktë në deklarimin e pakësimit të gjendjes *cash* në vitin 2006.

Në tabelën e mëposhtme llogariten mundësitë financiare të subjektit dhe bashkëshortes së tij për blerjen e pasurisë në vitin 2006, duke nisur nga likuiditeti i deklaruar në përgjigjet e pyetësorëve i akumuluar gjatë viteve 2003, 2004, 2005 dhe deri në blerjen e pasurisë në vitin 2006.

Gjendja e krijuar deri në fillim të vitit 2006, sipas deklarimeve të subjektit, si dhe nga përlllogaritjet financiare rezulton në vlerën 5.180.000 lekë.

		2006
1	GJENDJA E LIKUIDITETIT NË FILLIM	5.180.058lekë
2	TE ARDHURA	2.836.497lekë
	Të ardhura nga pagat e subjektit	1.269.970
	Të ardhura nga pagat e bashkëshortes	79.497
	Shitur automjeti “Mercedes-Benz”	250.000
	Hua A. P.	1.237.030 lekë
3	SHPENZIME	1.591.820lekë

	Shpenzime jetese	642.857
	Shpenzime udhëtimi	98.962
	Mobilimi i shtëpisë sipas pyetësorit	850.000
4	PASURI	5.232.637
5	GJENDJA E LIKUIDITETIT NË FUND	402.305lekë
	DIFERENCA (1+2-3-4-5)	789.793 lekë

Në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, më 10.01.2006, subjekti ka paguar këstin e parë prej 15.000 eurosh¹ (1.856.400 lekë), sipas mandatpagesës nr.1, datë 10.01.2006.

Këstin e dytë, prej 20.000 eurosh² (2.455.000 lekë), subjekti e ka paguar më datë 31.08.2006 me mandatin nr.2.

Këstin e fundit, prej 7.300 eurosh³ (902.572 lekë), e ka paguar me mandatin nr.3, datë 05.12.2006.

- ✓ Nga analiza e bërë rezulton se subjekti ka pasur aftësi paguese për shlyerjen e tri kësteve në datat e pasqyruara më sipër, pas likuidimit të të cilave i kanë mbetur në total 402.763 lekë.

Më tej, subjekti ka deklaruar se ka bërë edhe arredimin e kësaj pasurie, që për vitin 2006 deklarohet në shumën 850.000 lekë. I gjendur në pamundësi financiare, pasi shuma e mbetur ka qenë 402.763 lekë, i është nevojitur huaja e marrë nga z. P., në shumën 10.000 euro (1.237.030 lekë). Deklarimi i subjektit për kursime nga viti 2006 në shumën e përafërt prej 400.000 lekësh përputhet me llogaritjen e mësipërme.

- C. Si burim për ndërtimin e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar huan e marrë nga z. A. P., në shumën prej 10.000 eurosh, në vitin 2006.

Komisioni ka hetuar gjerësisht mbi mundësinë e krijimit të shumës së dhënë hua nga huadhënësi.

Në praktikën e ZVRPP-së Tiranë konstatohet se shtetasi A. P., ka pasur në emër të tij dhe bashkëshortes pasurinë nr. e 3***, indeksi i hartës ***, me sipërfaqe 135 m², ndodhur në Tiranë, në rrugën “***”. Po në këtë praktikë është administruar kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2006, që i përket kësaj pasurie, në shumën 5.900.000 lekë, lidhur midis shitësit A. P., dhe S. H., përfaqësuar me prokurën nr. *** rep., *** kol., datë 11.12.2006 nga subjekti i rivlerësimit, si dhe blerësi L. H.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e pasurisë apartament në rrugën “***” i ka marrë hua në shumën 10.000 euro vëllait të bashkëshortes, shtetasit A. P. Subjekti ka deklaruar se kjo marrëdhënie nuk ka qenë e shkruar. Pasi është pyetur nga ana e Komisionit, ai ka deklaruar se këtë hua e ka marrë *cash* dhe për të vërtetuar mundësitë financiare të huadhënësit, ka depozituar kontratën e shitblerjes së banesës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2006 (e cituar edhe më sipër), që huadhënësi ka pasur në pronësi të tij.

Komisioni është thelluar edhe në faktin që prokura e përfaqësimit nga z. A. P., dhe bashkëshortja e tij, znj. S. H., për shitjen e apartamentit është bërë një ditë përpara shitjes së

¹1 euro=123.76 lekë.

²1 euro=122.75 lekë.

³1 euro=123.64 lekë.

tij nga i përfaqësuari me prokurë, subjekti i rivlerësimit. Ky i fundit është pyetur se cila ka qenë arsyeja që z. P., e ka autorizuar atë dhe përse nuk e ka shitur ai vetë këtë banesë, duke marrë në konsideratë faktin që shitja është bërë një ditë më vonë se lëshimi i prokurës. Pyetja e Komisionit, përveç këtij konstatimi, ka ardhur edhe si rezultat i aksesit të drejtëpërdrejtë në sistemin TIMS, nga ku ka rezultuar që shtetasi P., dhe bashkëshortja e tij kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë më datë 16.05.2006 nëpërmjet pikës kufitare të Rinasit dhe kanë dalë nga ky territor më datë 05.06.2006, përsëri nga Rinasit. Ai është rikthyer në Shqipëri vetëm më datë 28.08.2007. Bazuar në këto të dhëna, z. P., dhe znj. H., rezulton se nuk kanë qenë në Shqipëri ditën e nënshkrimit të prokurës së lëshuar.

Subjekti ka deklaruar se më datë 08.12.2006, kunati i tij A.P., dhe bashkëshortja S. H., kanë ardhur në Shqipëri, ndërsa kanë udhëtuar fillimisht me avion për në Prishtinë dhe më pas me autobus për në Tiranë. Arsyeja e ardhjes ka qenë se bashkëshortja e z. P., ka pasur të atin me probleme shëndetësore. Në mbrëmjen e kësaj date, -ka deklaruar subjekti, -kunati ka kontaktuar me blerësin e pronës që kishte shfaqur interes për të blerë banesën e tij dhe më të ka rënë dakord për shitjen e saj. Duke qenë se blerësi ka qenë në pamundësi për të realizuar atë ditë pagesën e çmimit, ndërsa kunati, - ka deklaruar subjekti, -duhej të kthehej sërish në Zvicër, ka lëshuar prokurën e posaçme te noteri A. T., nëpërmjet së cilës e kanë emëruar përfaqësues për shitjen e apartamentit. Më tej, -ka shtuar subjekti në deklarimin e tij, -kunati ka udhëtuar në të njëjtën mënyrë për në Zvicër. Çmimi i shitjes, sipas deklarimeve të subjektit, ka qenë 5.900.000 lekë dhe me marrëveshje me kunatin A. P., ka mbajtur si hua një pjesë të saj që, e konvertuar, ka qenë 10.000 euro, kurse pjesën tjetër ia ka dorëzuar babait të kunatit, njëherazi edhe vjehrrin e subjektit, z. P. P. Subjekti ka lënë në çmim të hetimit nga Komisioni edhe thirrjen e z. P., për t'u pyetur, pasi ka bërë me dije se ndodhej në Shqipëri.

Komisioni verifikoi menjëherë praninë e z. P., në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nga të dhënat e sistemit TIMS rezultoi përsëri se z. P., nuk ndodhej në Shqipëri ditën e marrjes së përgjigjeve nga ana e subjektit. Gjithsesi, për të verifikuar saktësinë e deklaratës së subjektit, nëpërmjet këtij të fundit, u ftua z. P., për deklarim. Pavarësisht të dhënave negative të TIMS-it, të nxjerra në datën 10.06.2018, më datë 11.06.2018 z. P., u paraqit përpara Komisionit për deklarim.

Huadhënësi, z. P., është paraqitur me cilësinë e dëshmitarit më datë 11.06.2018, ora 10:45, identifikuar edhe me ID e tij si shtetas zviceran. Z. P., është pyetur në prani të Komisionit mbi vërtetësinë e akteve të lëshuara prej tij, pasurinë e paluajtshme të pasur më parë në emër të tij, mbi lëshimin e prokurës së posaçme për shitjen e saj, si dhe mbi udhëtimin në kohën e kryerjes së veprimit noterial, prokurës së posaçme.

Huadhënësi ka deklaruar *mbi vërtetësinë e plotë të akteve të lëshuara prej tij, prokurës së posaçme për shitjen e apartamentit që ka pasur në pronësi, deklaratën e lëshuar prej tij nr. *** rep., nr. *** kol., datë 08.06.2018, faktin e qëndrimit të subjektit të rivlerësimit në apartamentin e tij pa pagesë deri në shitjen e kryer, faktin se shtëpia e shitur ka qenë e tij si e vetmja gjë që ka bërë me të ardhurat nga karriera e tij si futbollist, si dhe udhëtimin e kryer prej tij nga Zvicra për në Shqipëri dhe anasjelltas, nëpërmjet Kosovës. Mbi dëshminë e huadhënësit, Komisioni ka mbajtur dhe administruar procesverbalin përkatës.*

Përveç dokumentacionit të ZVRPP-së, edhe dokumentacioni që subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion provon pasurinë që z. A. P., ka pasur në emër të tij më parë shitjes së saj.

Subjekti i rivlerësimit është pyetur nëse e ka kthyer këtë hua, nëse e ka kthyer vetë personalisht atë apo dikush tjetër, si dhe për mënyrën se si e ka shlyer.

Subjekti ka deklaruar se huan ia ka dhënë ai vetë prindërve të huadhënësit për shkak se ky i fundit jeton në Zvicër. Vlen të theksohet se prindërit e kumatit janë vjehërri dhe vjehërra e vetë subjektit.

Për të provuar këtë fakt, subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë 08.06.2018, dhënë nga z. P. P., me cilësinë e babait të huadhënësit, njëkohësisht edhe vjehërri i subjektit të rivlerësimit.

Në këtë deklaratë, babai i huadhënësit ka deklaruar se z. A. P., ka autorizuar për procedurat e shitjes së apartamentit të tij subjektin e rivlerësimit, i cili ka nënshkruar dhe marrë vlerën e parave të shitjes së saj.

Ai ka deklaruar se nga kjo shumë (5.900.000 lekë), subjekti, me cilësinë e dhëndrit të tij, me miratimin dhe lejen e djalit të tij, z. A.P., ka mbajtur vlerën prej 10.000 eurosh, e cila i nevojitej për të blerë një apartament në emër të tij e vazhës së tij, ndërsa pjesën tjetër nga totali i shitjes, 5.900.000 lekë, ia ka dhënë deklaruesit *cash*, ashtu siç ky i fundit kishte rënë dakord me djalin e tij.

Gjithashtu, subjektit është kërkuar të depozitohet edhe deklaratën tatimore vjetore për të ardhurat e huadhënësit në Zvicër për periudhën kohore 2006-2009. Subjekti ka depozituar gjashtë dokumente, që i përkasin shkurtit 2008, dhjetor 2011, dhjetor 2013, tetor 2015 dhe nëntor 2017.

Në përfundim të kësaj analize rezulton se huadhënësi ka pasur aftësi huadhënieje. Fakti që kjo hua nuk është e dokumentuar, mund të shpjegohet me afërsinë në lidhje gjinore ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit. Një marrëdhënie e tillë e afërt vërtetohet edhe nga fakti se këtë apartament, për të cilin u argumentua më sipër, subjekti i rivlerësimit e ka përdorur si vendbanim të tij për një kohë të gjatë pa pagesë.

Një fakt që bie në sy është se kjo hua nuk është deklaruar në Deklaratën-Vetting, ndryshe nga deklarata e vitit 2006. Ndërsa në deklaratën e vitit 2016 subjekti ka deklaruar shlyerjen e një pjese të kësaj huaje në shumën 7.500 euro dhe mbetur pa shlyer 2.500 euro.

Subjekti është pyetur për këtë mangësi dhe ai ka deklaruar se në momentin e plotësimit të Deklaratës-Vetting, kjo hua ishte shlyer nga kursimet familjare, prandaj e ka konsideruar blerjen e apartamentit me burim nga të ardhurat familjare.

Pavarësisht këtij deklarimi, Komisioni çmoi t'i kalojë barrën e provës subjektit në lidhje me këtë fakt.

Në shpjegimet e tij, z. Faqolli rikonfirmon se: *“Në Deklaratën e Pasurisë-Vetting kam deklaruar se burim krijimi për blerjen e apartamentit kanë shërbyer të ardhurat familjare ndër vite. Për shkak se huaja e marrë, e cila shërbeu për blerjen e apartamentit në momentin e plotësimit të Deklaratës së Pasurisë-Vetting ishte e shlyer (me burim nga të ardhurat familjare), si burim për blerjen e apartamentit rezulton se janë të ardhurat familjare. Si përfundim, kam deklaruar saktë burimin e krijimit për blerjen e apartamentit në deklaratën e interesave private periodik/vjetor 2006 dhe në Deklaratën e Pasurisë-Vetting.”*

Subjekti e ka përballuar barrën e provës për këtë rezultat të hetimit, nëpërmjet arsytimit. Komisioni, në vlerësim të argumenteve të paraqitura nga subjekti, si dhe provave të administruara, arsyeton se mospërputhja në dukje midis deklaratimit të burimit të kësaj pasurie në vitin 2006 me atë të bërë në Deklaratën-Vetting nuk vërteton ndonjë qëllim të subjektit për të fshehur burimin e pasurisë. Nga verifikimi i deklarimeve të tij ndër vite, duke filluar nga

viti 2006 e në vijim, subjekti e ka deklaruar rregullisht këtë hua. Në Deklaratën-Vetting kjo hua nuk deklarohet më. Nga dokumentacioni, dëshmitari dhe analiza financiare, rezulton hua e shlyer në këtë moment.

Në përfundim të kësaj analize, Komisioni çmon se duhet të pranojë arsyetimin e subjektit, si dhe vlerëson se nuk lindin dyshime të arsyeshme për fshehje të të ardhurave apo pasurisë.

→ Në lidhje me aftësinë paguese të subjektit për huat e shlyera në vitin 2016

Sipas deklaratës noteriale nr.***, datë 24.10.2016, z. Rr., ka deklaruar se ka marrë huan e dhënë subjektit në vitin 2011.

Subjekti, në deklaratën e pasurisë për vitin 2016, ka deklaruar shlyerjen e huas. Po në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar edhe shlyerjen e 7.500 eurove nga huaja e marrë në shumën 10.000 euro zotit P., kunatit të tij.

Mbi këto të dhëna dhe deklarime, Komisioni kreu analizën financiare, pasqyruar në tabelën më poshtë:

		2016
1	GJENDJA E LIKUIDITETIT NË FILLIM	480.381
2	TË ARDHURA	2.905.456 lekë
	Të ardhura nga pagat e subjektit	1.289.456
	Të ardhura nga pagat e bashkëshortes	1.068.000
	Të ardhura nga qiraja	348.000
	Të ardhura nga shitja e makinës	200.000
3	SHPENZIME	3.921.401 lekë
	Shpenzime jetese	642.857
	Shpenzime udhëtimi	351.702
	Shpenzime shkollimi	964.069
	Shpenzime mobilimi	35.000
	Shlyer huat	1.927.773
5	GJENDJA E LIKUIDITETIT NË FUND	139.045
	DIFERENCA (1+2-3-4-5)	-674.609

Nga analiza financiare e vitit 2016, Komisioni konstatoi një diferencë në shumën 674.609 lekë, duke krijuar dyshime të arsyeshme mbi pamundësinë financiare të subjektit për

shlyerjen e këtyre dy huave. Për këtë arsye, subjektit iu kalua barra e provës, në përfundim të hetimit administrative.

Në shpjegimet e tij, subjekti sqaron se: *“Në llogaritjet tuaja të pasqyruara në tabelën e analizës financiare të vitit 2016 është konsideruar se gjendja e likuiditeteve në fillim të vitit ka qenë 480.381 lekë. Në fakt, mendoj se përcaktimi në këtë shumë i gjendjes së likuiditeteve në fillim të vitit 2016 nuk është i saktë pasi, siç kam deklaruar në deklaratën e interesave private periodik/vjetor 2014, kam pasur gjendje cash shumë 300.000 lekë, kurse në deklaratën e interesave private periodik/vjetor 2015, kam shtuar gjendjen cash shumë 400.000 lekë. Pra, në total, për vitet 2014 dhe 2015, gjendja e likuiditeteve të mia në cash ka qenë 700.000 lekë. (shuma prej 700.000 lekësh është pakësuar e gjitha në vitin 2016).*

Të ardhurat e realizuara për vitin 2014 dhe 2015 mundësojnë shumat e deklaruara si kursime.

Për sa u përket të ardhurave të llogaritura nga ana juaj për vitin 2016, i konsideroj të sakta, pra të ardhurat familjare për këtë vit, nga pagat, qiradhënia dhe shitja e makinës janë në shumë totale 2.905.456 lekë.”

Subjekti ka paraqitur kundërshtimet e tij në lidhje me shpenzimet e llogaritura nga ana e Komisionit për vitin 2016, për pagesën e kryer për shkollimin e fëmijëve të tij në shumë 964.069 lekë. Ai argumenton se llogaritjet e bëra nga Komisioni janë bazuar në shkresën nr.*** prot., datë 15.01.2018, lëshuar nga “***”. Por subjekti konstaton se: *“...Në përgjigjen e dhënë nga “***” bëhet fjalë për shpenzime shkollimi, libra, uniforme, transport, për fëmijët e mi J. F., për vitet 2015,2016,2017 dhe D. F., për vitet 2016 dhe 2017.*

*Informacioni i dhënë nga “***”, në fakt, pavarësisht se duket sikur u referohet viteve kalendrike si më lart, në realitet u referohet viteve shkollore.*

*Në lidhje me shpenzimet si më lart, kam kërkuar informacion nga “***” dhe kam marrë përgjigjen nr.***prot., datë 11.07.2018, në të cilën evidentohen të gjitha pagesat e bëra nga unë për shkollimin e dy fëmijëve gjatë viteve 2015, 2016, 2017.”*

Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit:

- “Kthim përgjigjeje” nr. ***prot., datë 11.07.2018, lëshuar nga “***”.
- Një shkresë të firmosur nga ekonomisti i shkollës dhe subjekti i rivlerësimit për vazhën e tij, ku pasqyrohen pagesat e kryera.
- Marrëveshjen e datës 04.06.2017, nr. ***, për vitin shkollor 2016-2017 lidhur me shkollën për arsimimin e vajzës së subjektit të rivlerësimit. Në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje përcaktohen modalitetet e pagesës.
- Kontratë transporti nr. ***, datë 04.06.2016, lidhur me shkollën për transportimin e vajzës së tij me vlerë 475 euro.
- Listë porosie për libra 2016 – 2017, datë 04.06.2017, në vlerën 227 euro.
- Listë porosie uniforme 2016 – 2017, datë 04.06.2017, në shumë 135 euro.
- Depozitë cash, datë 17.11.2016, urdhëruar nga ana e z. P. P., për shumë 650 euro në favor të shkollës për vazhën e subjektit të rivlerësimit.
- Depozitim cash, datë 14.10.2016, urdhëruar nga ana e z. P. P., për shumë 650 euro në favor të shkollës për vazhën e subjektit të rivlerësimit.
- Depozitim cash, datë 14.10.2016, urdhëruar nga ana e z. P. P., për shumë 550 euro në favor të shkollës për djalin e subjektit të rivlerësimit.
- Kupon tatimor, pagesë shume 65.317,25 lekë, datë 08.09.2016.

- Një shkresë të firmosur nga ekonomisti i shkollës dhe subjekti i rivlerësimit për djalnin e tij, ku pasqyrohen pagesat e kryera për transportin në vlerën 475 euro më datë 08.09.2016.
- Kontratë transporti... lidhur me shkollën për transportimin e djalit të tij me vlerë 475 euro.
- Kupon tatimor, pagesë shume 76.065 lekë, datë 04.05.2016.
- Kupon tatimor, pagesë shume 23.096,10 lekë (*s'ka datë*).
- Mandat arkëtimi, datë 04.04.2016, për pagesën e regjistrimit, librave dhe uniformën për djalnin e subjektit të rivlerësimit, në vlerën 997 euro.
- Marrëveshjen e datës 04.05.2016, nr. *******, për vitin shkollor 2016-2017 lidhur me shkollën për arsimimin e djalit të subjektit të rivlerësimit. Në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje përcaktohen modalitetet e pagesës.
- Një shkresë të firmosur nga ekonomisti i shkollës dhe subjekti i rivlerësimit për vajzën e tij, ku pasqyrohen pagesat e kryera.
- Marrëveshjen e datës... për vitin shkollor 2015-2016 lidhur me shkollën për arsimimin e vajzës së subjektit të rivlerësimit. Në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje përcaktohen modalitetet e pagesës.
- Kontratë transporti... lidhur me shkollën për transportimin e vajzës së tij me vlerë 475 euro.
- Lista e librave
- Mandatarkëtimi për uniformën e vajzës së subjektit të rivlerësimit, datë 28.05.2015, në vlerën 230 euro.
- Mandatarkëtimi për librat e vajzës së subjektit të rivlerësimit, datë 28.05.2015, në vlerën 208 euro.
- Depozitim *cash*, datë 07.02.2017, urdhëruar nga ana e z. P. P., për shumën 1.100 euro në favor të shkollës për djalnin e subjektit të rivlerësimit.
- Depozitim *cash* datë 11.04.2017 urdhëruar nga ana e Z. P. P., për shumën 550 euro në favor të shkollës për djalnin e subjektit të rivlerësimit
- Depozitim *cash* datë 07.11.2017 urdhëruar nga ana e Z. P. P., për shumën 550 euro në favor të shkollës për djalnin e subjektit të rivlerësimit
- Depozitim *cash* datë 22.12.2017 urdhëruar nga ana e Z. P. P., për shumën 550 euro në favor të shkollës për djalnin e subjektit të rivlerësimit
- Depozitim *cash* datë 24.01.2017 urdhëruar nga ana e Z. P. P., për shumën 650 euro në favor të shkollës për vajzën e subjektit të rivlerësimit
- Mandat arkëtimi datë 27.05.2017 për për pagesën e regjistrimit, librave dhe unifomën për djalnin e subjektit të rivlerësimit në vlerën 1218 euro.
- Kupon tatimor pagesë shume 163,735.74 lekë datë...05.2017
- Marrëveshjen e datës 27.05.2017, nr. *******, për vitin shkollor 2017-2018 lidhur me shkollën për arsimimin e djalit të subjektit të rivlerësimit. Në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje përcaktohen modalitetet e pagesës.
- Kontratë transporti, datë 27.05.2017, nr. *******, lidhur me shkollën për transportimin e djalit të tij me vlerë 500 euro.
- Depozitim *cash*, datë 02.10.2017, urdhëruar nga ana e z. P. P., për shumën 650 euro në favor të shkollës për vajzën e subjektit të rivlerësimit.
- Depozitim *cash*, datë 17.11.2017, urdhëruar nga ana e z. P. P., për shumën 650 euro në favor të shkollës për vajzën e subjektit të rivlerësimit.

Sqarimet e subjektit, bazuar në dokumentacionin përkatës, janë pasqyruar në tabelën më poshtë, duke ndryshuar rezultatin për vitin 2016:

	2016
--	------

1	GJENDJA E LIKUIDITETIT NË FILLIM	780.381 lekë
2	TË ARDHURA	2.905.456 lekë
	Të ardhura nga pagat e subjektit	1.289.456
	Të ardhura nga pagat e bashkëshortes	1.068.000
	Të ardhura nga qiraja	348.000
	Të ardhura nga shitja makinës	200.000
3	SHPENZIME	3.610.280 lekë
	Shpenzime jetese	642.857
	Shpenzime udhëtimi	351.702
	Shpenzime shkollimi	652.948
	Shpenzime mobilimi	35.000
	Shlyer huat	1.927.773
5	GJENDJA E LIKUIDITETIT NË FUND	139.045 lekë
	DIFERENCA (1+2-3-4-5)	-63.488

Diferenca që rezulton nga kjo rillogaritje, nuk mund të merret në konsideratë nga Komisioni, duke pasur parasysh një marzh minimal gabimi në llogaritjen e shpenzimeve.

4. Automjet tip “Mercedes-Benz”, blerë sipas kontratës Nr. *, datë 20.03.2014 në vlerën 5.000 euro.**

Burimi i deklaruar i krijimit, sipas “Deklaratës-Vetting”: *Të ardhurat familjare.*

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 20.03.2014 për blerjen nga subjekti i rivlerësimit të automjetit tip “Mercedes-Benz” në vlerën 5.000 euro.
- Shkresë nr. ***, datë 20.10.2016 e DPD-së, dega Durrës, bashkëlidhur kopja e deklaratës doganore dhe dokumentacioni shoqërues i njehsuar me origjinalin.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot, datë 04.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor.
-Me shkresën nr. ***prot, datë 12.01.2018, DPSHTRR ka informuar se: subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin me targë ***, deri në datë 31.10.2016.
- Shkresë nr. *** prot., datë 04.01.2018, drejtuar AMF-së.
-Me shkresën nr. ***prot., datë 24.01.2018, AMF informon se: subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur me të, si dhe fëmijët, janë të siguruar me tipin e policës “shëndet në udhëtim” dhe në 6 raste TPL për subjektin e rivlerësimit, pranë shoqërisë “***”.
- Shkresë nr. ***prot., datë 26.02.2018, drejtuar shoqërisë “***” sh.a.
-Me shkresën nr. *** prot., datë 06.03.2018, shoqëria “***” ka informuar se:Automjeti me targë ***ka pasur TPL për periudhën deri më datë03.12.2015, ndërsa ai me targë ***ka pasur TPL deri më datë 20.03.2017 dhe karton jeshil deri më 31.07.2017.

Arsyetimi ligjor

Në lidhje me këtë pasuri Komisioni, pasi hetoi mbi vërtetësinë e deklarimeve të subjektit, i gjen ato të sakta.

Në lidhje me aftësitë blerëse të subjektit për këtë makinë, Komisioni kreu analizën financiare si më poshtë:

		2014
1	GJENDJA E LIKUIDITETIT NË FILLIM	942.109 lekë
2	TË ARDHURA	2.167.553 lekë
	Të ardhura nga pagat e subjektit	1.249.913
	Të ardhura nga pagat e bashkëshortes	410.640
	Të ardhura nga qiraja	480.000
	Të ardhura të tjera	27.000
3	SHPENZIME	1.368.599 lekë
	Shpenzime jetese	642.857
	Shpenzime udhëtimi	690.742
	Shpenzime mobilimi	35.000
4	PASURI	700.550
	Automjet tip “Mercedes-Benz”	700.550
5	GJENDJA E LIKUIDITETIT NË FUND	379.984 lekë
	DIFERENCA (1+2-3-4-5)	660.529

Në përfundim të hetimit dhe analizës financiare, Komisioni vlerëson se nuk duket të ketë dyshime mbi këtë pasuri. Subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e saj.

5. Llogari në “Alpha Bank” me balancë 48.201 lekë.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas “Deklaratës-Vetting”: *Llogari page*.

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Nxjerrje llogarie “Alpha Bank”, datë 23.01.2017, me gjendje në vlerën 48.201 lekë.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. *** prot., datë 26.02.2018, drejtuar “Alpha Bank”.

- Me shkresën nr. *** prot., datë 04.06.2018, “Alpha Bank” ka konfirmuar llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje në datën 29.12.2017 në vlerën: 163.906,76 lekë. Kjo llogari kreditohet nga paga e subjektit.

Nga verifikimi i *statement*-it të dërguar nga “Alpha Bank” konstatohet se subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e tij.

6. Llogari e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në bankën “BKT”, me gjendje në datën 23.01.2017 në shumën 12.912 lekë.

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Nxjerrje llogarie “BKT”, datë 23.01.2017, me gjendje në vlerën 12.912lekë.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr.*** prot., datë 29.12.2017, drejtuar “BKT”-së.

- Me shkresën nr. ***prot., datë 19.01.2018, “BKT” ka konfirmuar këtë llogari bankare në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Kjo llogari kreditohet nga paga si e punësuar pranë kompanisë farmaceutike “***” sh.p.k.

Nga i hetimi i Komisionit rezulton se në deklaratat periodike vjetore subjekti:

- ❖ Nuk deklaron disa llogari bankare në lekë të bashkëshortes pranë BKT-së, me numër ***. Këtë llogari e deklaron vetëm në vitin 2016.

	2012	2013	2014	2015
BKT ***	357.196	377.628	19.456	49.847

- ❖ Nuk deklaron në vitet 2007 - 2011 llogaritë bankare të bashkëshortes në “Procredit Bank”.

	2007	2008	2009	2010	2011
Procredit ***			12.067	33.815	174
Procredit ***	440	155.768	412.180	145.969	20.010

Pavarësisht se subjekti ka deklaruar për këto vite të ardhura shtesë, ashtu siç e parashikon ligji, është e paqartë nëse këto shuma janë pjesë e këtyre të ardhurave apo jo.

Duke konstatuar se subjekti ka qenë i pasaktë në deklarimin e të ardhurave ndër vite të bashkëshortes së tij, pavarësisht se burimi i tyre është të ardhurat nga paga, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës. Në shpjegimet e tij, subjekti sqaron se: *“Në deklaratat e interesave private periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite në ILDKPKI, kam deklaruar saktë të ardhurat nga pagat e mia dhe të bashkëshortes. Këto të ardhura kanë kaluar nëpërmjet llogarive bankare. Duke deklaruar të ardhurat nga pagat, kam menduar se kam përmbushur detyrimin ligjor. Por, gjithashtu, sqaroj se në deklaratat e interesave private ndër vite kam deklaruar shtesa/pakësime në likuiditete cash (këtu kam pasur parasysh likuiditetet cash në banesë dhe likuiditete në bankë) dhe shumat që referohen si të padeklaruar nga ana ime në fakt janë deklaruar nga unë si kursime për vitet përkatëse, pa specifikuar si likuiditete cash në banesë apo në bankë, por duke konsideruar që janë likuiditete cash.”*

Duke arsyetuar për sa më sipër, Komisioni konstaton se këto të ardhura janë në gjendje llogari bankare rrjedhëse, pra lehtësisht të verifikueshme, absolutisht të pamundura për t’u fshehur. Kjo do të thotë që përjashtohet si mundësi fshehja e të ardhurave. Nga ana tjetër, edhe nëse do të konsideroheshin si shuma të kursyera të padeklaruar, nuk i përkasin Deklarimit-Vetting, por viteve të mëparshme. Në shkresën e saj nr. ***prot., datë 16.04.208, ILDKPKI sqaron se ligji nr. 9049/2003, botuar në Fletoren Zyrtare të majit 2003, përcakton shprehimisht detyrimin e subjekteve të deklarojnë: *“d) vlerën e likuiditeteve, gjendje cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë dhe në valutë”*. Pra, të gjitha në një zë, pa përcaktuar detyrimin për t’i ndarë në zëra.

Ndërsanë pikën 2 të nenit 2 të po këtij ligji, përcaktohet përkufizimi i termit *likuiditet*: “*Likuiditete janë mjetet monetare, të vendosura cash, llogari rrjedhëse, depozita, me dhe pa afat, bono thesari, obligacione dhe huadhënie*”.

Në ndryshimet që iu bënë këtij ligji në vitin 2014, u ndryshua shkronja (d) e mësipërme: “*d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.*”

Në këtë kuptim, Komisioni çmon se subjekti ka argumentuar saktë në shpjegimet e tij, kur ka përfshirë në deklaratimet e kursimeve vjetore edhe shumën e patërhequr nga paga, në fund të vitit ushtrimor. Nga analiza financiare e kryer, pranohet një fakt i tillë, sepse edhe shumat nuk janë të mëdha. Në këtë vlerësim të Komisionit ndikon në mënyrë të veçantë fakti që këto shuma janë me burim pagën, pra burim krejtësisht i ligjshëm, dhe janë gjendje në llogari bankare rrjedhëse, pra pa asnjë tendencë për t’i fshehur.

◆ Konkluzioni përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë

Subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë:

- pakësimin e gjendjes *cash* në deklarinimin e tij në vitin 2006;
- deklarinimin në “lekë të vjetër” në vitet 2004 dhe 2005 të kursimeve *cash*.

Por, nuk u gjetën prova apo indice që këto pasaktësi në deklarime janë bërë me qëllim fshehjen e burimit, të ardhurave apo pasurisë.

Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, këto pasaktësi nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se në këtë rast pasaktësitë e konstatuara nuk çmohen se cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësia.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezultojnë të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit Astrit Faqolli nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. 1237, datë 23.04.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarinimit për kontrollin e figurës.

Nga ana e DSIK-së, konform nenit 36 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁴ është administruar informacioni që disponohet për subjektin e rivlerësimit nga institucionet ligjzbatuese, SHISH, SHKÇBA, DSIK.

DSIK ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku rezulton se:

“Për subjektin e rivlerësimit, Astrit Faqolli, administrohen. . . informacione. . . , nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

*Informacioni i ardhur nga institucioni verifikues bën me dije se në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, Astrit Faqolli, disponohen të dhëna të vitit . . . , nga të cilat **ngrihen dyshime për përfshirje në korrupsion pasiv.***

Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, Astrit Faqolli, për implikimin e tij në një veprimtari korruptive, evidentojnë rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston një kontakt i papërshtatshëm, sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 në formën e një takimi të qëllimshëm në papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

Referuar këtij informacioni, subjekti i rivlerësimit, Astrit Faqolli, rezulton individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga struktura kriminale, sipas përcaktimit të germës “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016.

Sipas përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, që përfshin veprat penale, që sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale janë në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda, ose të çdo gjykate tjetër që mund ta zëvendësojë atë në ushtrimin e këtyre kompetencave, subjekti i rivlerësimit është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit kryer në bashkëpunim. . .

Merret në konsideratë si rrethanë lehtësuese fakti që informacioni i institucionit verifikues . . . , pra para periudhës së përcaktuar në ligj - 01.01.2012.”

Raporti, në përfundim, konstaton **papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Astrit Hysen Faqolli.**

Në vijim të procesit të verifikimit të figurës, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe garantimin e të drejtave të subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe referuar vendimit Nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni mund të kryejë hetim të thelluar.

Mënyra e kontrollit të figurës detajohet brenda parimeve kushtetuese dhe ligjit nr.84/2016 që, në nenin 34 të tij përcakton qartë objektin e kontrollit të figurës: *“Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës”.*

⁴“Struktura përgjegjëse për kontrollin e figurës 1. Institucionet e rivlerësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar janë autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar ka të drejtë të caktojë një personel shtesë, për të kryer kontrollin e figurës për qëllim të këtij ligji. Personat që kryejnë kontrollin e figurës përbushin standardet e zbatueshme për mbrojtjen e privatësisë dhe të konfidencialitetit në detyrë. 2. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHKÇBA) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme krijojnë një grup pune për zbatimin e këtij ligji. Këto struktura mund të caktojë personel për të mbështetur grupin e punës për një periudhë kohe jo më pak se 1 vit. 3. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, me kërkesë të grupit të punës ose të institucioneve të rivlerësimit, ka të drejtë të komunikojë me shtetet e tjera për të marrë informacionin e nevojshëm për personat e përfshirë në krimin e organizuar ose për personat e dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar për qëllim të këtij ligji”.

Duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, duhet të jetë gjithnjë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit kërkohet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij.

Standardet e kontrollit të figurës i përcakton vetë ligji. Gjithë procesi duhet të zhvillohet bazuar **në prova të sakta** (neni 38), **në mënyrë objektive**, që përfshijnë vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në disa lloj konstatimesh, të renditura qartë në paragrafin 4 dhe 6 të nenit 38 të ligjit.

Rrethanat ku duhet të bazohet vlerësimi sa i përket kontrollit të figurës përcaktohen në paragrafin 4 të nenit 38 të grupuara në 5 kategori:

- a) *subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- b) *subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- c) *subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- c) *subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- d) *subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.*

Raporti i Grupit të Punës së DSIK-së (*informacioni që përmbante*)iu nënshtua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e rrethanave që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanave lehtësuese, të rrjedhura nga informacioni që kishte marrë Grupi i Punës dhe kishin çuar në konstatimin e *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*, si dhe vërtetësisë së ngjarjes konkrete, me qëllim gjetjen e provave, për realizimin e një procesi të rregullt ligjor.

Komisioni konstatoi se informacioni i përcjellë nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr.84/2016 dhe ai konsiderohet i paplotë. Informacioni në çdo rast duhet të jetë i bazuar mbi prova të sakta, kjo është edhe fryma e ligjit për krijimin e grupit të punës. Nëse Grupi i Punës nuk do të bëjë një verifikim të plotë, atëherë ai rrezikon të nxjerrë përfundime të gabuara dhe të rëndojë pozitën e subjekteve të rivlerësimit. Në këtë rast, Grupi i Punës nuk ka kryer verifikime të mëtejshme, duke arritur në konkluzion vetëm mbi bazën e informacionit të paverifikuar.

Po ashtu, duhet theksuar se në pikën 2 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës është sanksionuar se deklarata e detajuar (prej së cilës fillon edhe verifikimi i figurës), mbulon periudhën **nga data 1 janar 2012** deri në ditën e deklarimit, sipas ligjit -dhe ky është kriter kushtetues. Informacioni i përdorur për arritjen në konkluzion nga Grupi i Punës nuk i përket kësaj periudhe.

Për të krijuar bindjen e brendshme, si dhe për të plotësuar kuadrin e procesit hetimor administrativ, Komisioni administroi dhe shqyrtoi fashikullin e plotë të procesit të ndjekur nga subjekti në pozicionin e në vitinpër rastin në fjalë.

Në këto kushte, duke analizuar raportin e ardhur nga DSIK-ja dhe organet ligjzbatuese, duke bërë një studim të thelluar të tyre, duke administruar provat e tjera në lidhje me çështjen, Komisioni çmon se informacioni mbi të cilin ka ardhur rekomandimi i DSIK-së **rezulton i pasaktë dhe i pabazuar në prova dhe fakte**, për pasojë subjekti Astrit Faqolli konsiderohet i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar 3 dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dosjeve, të përzgjedhura me short, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. 2969/3 prot., datë 22.01.2018.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve civile. Ai identifikon normën ligjore të zbatueshme në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes gjyqësore. Paraqet përmbajtjen e normës ligjore materiale dhe nxjerr konkluzione mbi çështjen nga zbatimi i saj.

Subjekti i kushton rëndësi përcaktimit të faktit të mosmarrëveshjes, për të vijuar me identifikimin e natyrës së mosmarrëveshjes dhe zbatimit të normës materiale për zgjidhjen e saj. Kur është rasti, subjekti i rivlerësimit përdor në vendimet e arsyetuara edhe ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre. Subjekti përdor edhe referenca në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Subjekti identifikon rastet kur, për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen, duhen njohuri të posaçme, duke thirrur ekspertët e fushës, por nuk tregon kujdesin e duhur për të saktësuar pyetje shteruese për ekspertin. Në disa raste, ai tregon në vendim konceptet kyçe që përmban norma ligjore e përdorur për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Gjithashtu, është konstatuar se subjekti përdor në mënyrë të shprehur parimet e përgjithshme të së drejtës, siç është parimi i disponibilitetit të padisë dhe ai i përmbushjes në natyrë të detyrimit apo parimi i fuqisë së plotë provuese të akteve zyrtare.

Tri dokumentet e përzgjedhura prej tiju përkasin vendimeve civile, përkatësisht: vendimit nr. 4307, datë 03.04.2014; nr. 7356, datë 25.06.2014 dhe nr. 10306, datë 27.10.2014. Në analizë të përbashkët të tri dokumenteve, konstatohet se subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e vendimeve dhe organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel mesatar. Tekstet paraqiten me strukturë të qartë. Në to janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, referencat në ligj jepen duke cituar me nënvizim dispozitën ligjore dhe fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme.

Tri dokumentet e përzgjedhura prej tij dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë në të drejtën civile materiale dhe procedurale, ku dallohet e drejta e detyrimeve, ekzekutimi i

detyrueshëm i titujve, e drejta e punës dhe fitimi i pronësisë me trashëgim. Gjithashtu, ai ka njohuri edhe për masat e sigurimit.

Rezulton se në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara palët ndërgjyqëse nuk kanë paraqitur ankim kundër vendimit të dhënë prej tij, çka ka bërë që vendimet të jenë të formës së prerë dhe për pasojë të bëhen të ekzekutueshme.

b) Arsyetimi ligjor

Vendimet gjyqësore të hartuara prej subjektit të rivlerësimit janë të qarta, të thjeshta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e thjeshtë dhe e standardizuar. Vendimet gjyqësore të tij plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penal apo kërkesat e legjislacionit procedural penal.

Pjesa hyrëse e vendimit është e plotë dhe palët ndërgjyqëse tregohen me gjeneralitete të plota të tyre, si dhe me të dhëna për përfaqësimin në gjykim. Një tipar i mirë i punës së tij është tregimi në pjesën hyrëse me shkrim të theksuar për pjesëmarrjen ose mungesën e palëve në gjykim, që lehtëson procedurat e komunikimit të vendimit në përfundim të gjykimit.

Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur subjekti në cilësinë e gjyqtarit. Analiza ligjore është sintetike dhe orientohet më shumë drejt nxjerrjes së konkluzioneve nga citimi i dispozitave ligjore relevante. Në një rast, është konstatuar se për identifikimin e masës së sigurimit, analiza është bërë pa referenca ligjore. Përgjithësisht, në arsyetim ai fokusohet te thelbi i çështjes dhe konkretizimi i tij sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetim të tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina.

Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast, nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në të 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët.

Gjithashtu, është konstatuar se ai i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen pas marrjes së mendimit të palëve, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dhomën civile. Ai ka deklaruar se në periudhën 2013 - 2016 i janë caktuar për gjykim 1459 çështje civile dhe ka përfunduar 1078 çështje civile, duke mbartur 162 çështje. Gjithashtu, ai ka deklaruar se gjatë kësaj periudhe i janë caktuar edhe 309 masa sigurimi. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në të dhënat për çështjet civile, është 73.8%.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, gjyqtari Astrit Faqolli ka përfunduar gjithsej 1236 çështje gjyqësore, nga të cilat 1 penale, 435 civile të përgjithshme, 7 tregtare, 292 kërkesa penale dhe 501 kërkesa civile.

Sipas pikës 3, germa "e", të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë i dhomës civile duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 120 gjykime çështjesh civile. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 360 gjykime çështjesh civile për tre vjet. Duke zbatuar këtë rregull në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, konstatohet se ngarkesa e tij sasiore ka qenë mbi standardin sasior.

Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Astrit Faqolli ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë, referuar *dosjes 5* me objekt masë sigurimi, deri në 1 vit, 3 muaj e 8 ditë, referuar *dosjes 3*, që i përket vendimit nr. 6821, datë 18.09.2015. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit, 1 vit, 3 muaj e 8 ditë, ka qenë çështje civile themeli, e shqyrtuar në 17 seanca dhe në përfundim është disponuar me vendim pranimi i padisë, vendim i cili rezulton i paankimuar. Në tri dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 2 muaj e 16 ditë, referuar *dosjes 1*; 4 muaj e 3 ditë referuar *dosjes 2* dhe 2 muaj e 24 ditë, referuar *dosjes 4*.

Në 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në 4 raste është respektuar afati ligjor apo afati standard i gjykimit. Ndërsa në 1 rast, konkretisht atij që i përket *dosjes 3*, afati standard i gjykimit është kaluar dhe është konstatuar cenim i procesit të rregullt ligjor. Shkak për tejkalimin e afatit standard është bërë mungesa e përgatitjes së paditësit, sjellja dhe paqartësia e ekspertit, si dhe mosmarrja e masave të duhura nga gjyqtari për disiplinimin e sjelljes së tyre.

Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve, në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit nuk mund të nxirren përfundime, pasi nuk ka të dhëna se kur janë regjistruar apo shortuar çështjet.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, përgjithësisht i ka arsyetuar shpejt vendimet gjyqësore. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 5 ditë nga shpallja e vendimit nr. 7486, datë 07.10.2015, për 8 ditë nga shpallja e vendimit nr. 8730, datë 11.09.2014, për 11 ditë nga shpallja e vendimit nr. 6821, datë 18.09.2015, për 13 ditë nga shpallja e vendimit nr. 4510, datë 08.04.2014 dhe për 28 ditë nga shpallja e vendimit nr. 1637 akti, datë 24.06.2016.

Ndër 5 dosjet e vëzhguara, 3 prej tyre janë arsyetuar brenda afatit ligjor, konkretisht *dosjet 1* dhe *2*, ndërsa 3 të tjera janë arsyetuar në tejkalim të afatit, konkretisht *dosjet 3, 4 dhe 5*.

Vonesë problematike ka pasur në *dosjen 5*, që i përket vendimit nr. 1637 akti, datë 24.06.2016, prej 28 ditësh, duke marrë në konsideratë natyrën e vendimit për masë sigurimi, megjithëse duhet evidentuar se vendimi nuk është ankimuar nga palët.

Gjatë periudhës së rivlerësimit për gjyqtarin Astrit Faqolli janë paraqitur gjithsej 7 ankesa në Inspektoratin e KLD-së. Nga shqyrtimi administrativ i tyre nuk kanë rezultuar të dhëna negative për veprimtarinë e tij profesionale dhe etike.

Nga këto të dhëna dhe argumente, konstatohet se gjyqtari Astrit Faqolli ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ai ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal,

përgjithësisht ka respektuar afatet standarde të gjykimit të çështjeve që i janë caktuar, si dhe në shumicën e rasteve ka arsyetuar pa vonesa vendimet gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, Astrit Faqolli, merr masat për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, me qëllim përfundimin në kohë të tyre. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në 3 çështje civile themeli të vëzhguara, ai ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore, duke saktësuar kërkimet e palëve dhe duke verifikuar nëse ekzistonte mundësia e palëve për ta zgjidhur çështjen me pajtim, referuar *dosjeve nr. 2, 3 dhe 4*. Veprimet përgatitore janë dokumentuar me shkrim, me akt të mbajtur nga gjyqtari.

Në 4 çështje civile të vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë, referuar *dosjes 1*, me 5 seanca, referuar *dosjes 2*, me 17 seanca, referuar *dosjes 3* dhe me 6 seanca, referuar *dosjes 4*. Ndërsa çështja tjetër e vëzhguar, referuar *dosjes 5*, lidhet me vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit, është përfunduar me 1 seancë. Konkretisht janë vëzhguar 30 seanca gjyqësore, nga të cilat 16 kanë qenë produktive. Pengesë në 14 seanca gjyqësore janë bërë mungesa e përgatitjes së palëve ndërgjyqëse në 2 seanca, njoftimi i parregullt i palëve në 2 raste, mungesa e gjyqtarit në 2 seanca, kërkesa e paditësit për shtyrjen e seancës në 1 rast, mospërbushja e detyrës nga eksperti dhe mungesa e përgatitjes së paditësit për ekspertimin në 6 seanca, si dhe mungesa pa shkaqe e palëve në 1 seancë. Ndër 32 seanca gjyqësore të vëzhguara, vetëm 2 prej tyre kanë dështuar nga mungesa e gjyqtarit për shkak të pjesëmarrjes së tij në aktivitete të tjera profesionale, më konkretisht referuar *dosjes 3*. Nuk janë identifikuar të dhëna për fillimin me vonesë të seancave gjyqësore. Ndër seancat e vëzhguara, vetëm 2 prej tyre, përkatësisht *dosjet 3 dhe 4*, janë dokumentuar se janë zhvilluar në sallë gjykimi me regjistrim audio.

Gjatë gjykimit, subjekti i rivlerësimit identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara për realizimin e tyre. Distancat kohore midis seancave janë të arsyeshme dhe në raport me shkakun për të cilin seanca është shtyrë. Janë konstatuar vetëm 2 seanca të planifikuara përtej afateve ligjore, konkretisht në *dosjet 3 dhe 4*. Përgjithësisht subjekti ka monitoruar njoftimet e palëve për të shmangur vonesat në dërgimin e tyre apo për të siguruar zhvillimin korrekt të gjykimit. Në *dosjen 1*, aktet e njoftimit janë nisur me vonesë, por megjithatë njoftimi i palëve është realizuar. Ndërsa në *dosjen 3* ka pasur 2 seanca të dështuara për shkak të njoftimit të parregullt të palëve.

Ai zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Rast përjashtimor konstatohet mosbërja me dije e përbërjes së trupit gjykues palës së paditur të paraqitur me vonesë në gjykim, në *dosjen 2*, që i përket vendimit gjyqësor nr. 8730, datë 11.09.2014.

Subjekti orienton drejt debatit dhe hetimit gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar. Në *dosjen 3* është konstatuar se menaxhimi i çështjes nga gjyqtari në drejtim të disiplinimit të sjelljes së palëve nuk ka qenë në nivelin e duhur. Në të gjitha rastet disponon me vendime të ndërmjetme e me shkak ligjor për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se përgjithësisht ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Në të gjitha rastet civile, gjyqtari ka caktuar seancën e parë me akt formal, ndërsa vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, i

marrë pas veprimeve paraprake, është hartuar veçmas prej tij dhe është përfshirë rregullisht në dosjet 2, 3 dhe 4. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur akt me shkrim nga vetë gjyqtari, në të cilin nuk dokumentohet ora e fillimit të seancës përgatitore, konkretisht në *dosjet nr. 1, 2, 3 dhe 4*. Ndërsa në çështjen penale që i përket *dosjes 5*, për masë sigurimi, caktimi i seancës gjyqësore nuk është dokumentuar.

Gjithashtu, në çdo dosje civile janë përfshirë rregullisht padia dhe provat e paditësit, aktet e njoftimit të palëve dhe kërkesat me shkrim të palëve. Këto akte mungojnë në *dosjen 3*. Po në këtë dosje mungon edhe raporti mjekësor i paditësit, që është relatuar si shkak për shtyrjen e seancës. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë, duke plotësuar kriteret e nenit 118 të Kodit Procedurës Civile. Në procesverbalin gjyqësor të 1 seance të kësaj dosjeje ka gabim material në orën e përfundimit të seancës. Ndërsa në 2 seanca të tjera, në *dosjen 2 dhe 4*, kur është shpallur vendimi përfundimtar, nuk është dokumentuar ora e përfundimit të tyre. Në *dosjen 5* procesverbali i seancës gjyqësore penale është i hartuar përgjithësisht në përputhje me nenet 345/1 dhe 346 të Kodit të Procedurës Penale, por ora e paraqitjes së kërkesës së prokurorit në gjykatë dhe ora e përfundimit të seancës nga gjyqtari nuk është dokumentuar, duke krijuar vështirësi për përlllogaritjen e kohëzgjatjes së gjykimit në orë, siç kërkon neni 259/5 i Kodit të Procedurës Penale.

Në fashikull përfshihen vendimet gjyqësore dhe dëftesat e komunikimit të vendimit për palët në mungesë. Në *dosjen 2* nuk rezulton të ketë vendim për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, sipas nenit 310/1 të Kodit të Procedurës Civile. Aktet në të gjitha dosjet janë sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale civile, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët. Çdo dosje gjyqësore është e inventarizuar rregullisht.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjyqtari Astrit Faqolli ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 01.07.1992. Pas studimeve, më datë 17.11.1997 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd. Më 31.07.2003 është emëruar inspektor i Inspektoratit të KLD-së, ndërsa në datën 05.04.2010 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranëmë 20.12.2013, ku vazhdon edhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Astrit Faqolli. Kjo reflektohet edhe nga të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së, pasqyruar më poshtë në këtë raport. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Faqolli. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të

rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e standardit të gjykatës së paanshme. Në *dosjen 2*, përbërja e trupit gjykues nuk i është bërë me dije palës së paditur të paraqitur me vonesë në gjykim, por kjo e dhënë nuk ka sjellë pasojë cenimin e të drejtave të palëve dhe si e tillë, është konsideruar se lidhet me *Aftësitë organizative* të gjyqtarit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Astrit Faqolli komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Astrit Faqolli për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në të gjitha rastet, subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtar i vetëm për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile e penale. Në 5 dosjet nuk është identifikuar vonesë në fillimin e seancave gjyqësore apo në depozitimin e dosjes me vendimin e arsyetuar në sekretari për shkak të bashkëpunimit të dobët.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 9 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Konkretisht, konstatohen pjesëmarrje në aktivitete trajnuese si: “Neni 10 i KEDNJ, Praktika gjyqësore lidhur me fyerjen dhe shpifjen”; “Pyetja e të pandehurit, deklaratimet e të bashkëpandehurit ose të pandehurit në një procedim të lidhur. Respektimi i kontradiktoritetit në përfaqje me jurisprudencën e GJEDNJ-së”; “Zgjidhja e kontratës së punës. (Procedura e zgjidhjes së kontratës së punës. Zgjidhja e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme. Zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës. Praktika gjyqësore dhe jurisprudenca e GJK-së dhe GJL-së)”; “Problematika e gjykimit të drejtpërdrejtë. Gjykimet e posaçme dhe gjykimet e shkurtuara”; “Vepra penale ‘pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale’. (Problemet e evidentuara në fazën e hetimit dhe gjykimit. Pastrimi i parave dhe aspektet procedurale. Legjislacioni, standardet ndërkombëtare dhe Konventa e Varshavës e ratifikuar nga Shqipëria. Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit: - nenet 287, 287/b dhe 230 e vijues të K.Penal). Hetimi financiar kriminal. Konfiskimi. Praktika gjyqësore dhe jurisprudenca e GJL-së”; “Shkrimi ligjor dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore, elementet e tij sipas dispozitave procedurale dhe materiale. Pasojat e mosarsyetimit të vendimit”; “Ekzekutimi i detyrueshëm. Mjetet e mbrojtjes”; “Gjykimimi në mungesë në procesin civil”, si dhe “Pavlefshmëria e themelimit të shoqërive tregtare. Ndryshimet e reja ligjore. Çështje të teorisë dhe praktikës”.

Nga këto të dhëna është konstatuar se ai ka marrë pjesë në 17 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve ku ai ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme

me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomës civile. Nuk dokumentohet që gjyqtari Astrit Faqolli të jetë angazhuar në aktivitete të tjera profesionale.

❖ TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtari Astrit Faqolli ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 01.07.1992. Pas studimeve, në datën 17.11.1997 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd. Në datën 31.07.2003 është emëruar inspektor i Inspektoratit të KLD-së, ndërsa në datën 05.04.2010 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Në datën 20.12.2013 është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon edhe aktualisht. Nuk konstatohen mospërputhje me të dhënat e deklaruara nga vetë subjekti në Formularin e Vetëvlerësimit.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për gjyqtarin Astrit Faqolli janë paraqitur gjithsej 7 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (asnjë ankesë në vitin 2013, 5 ankesa në vitin 2014, asnjë ankesë në vitin 2015 dhe 2 ankesa në vitin 2016).

5 ankesa të vitit 2014 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, nga të cilat 3 ankesa me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe 2 ankesa me pretendimin se janë ankesa të paraqitura dhe më përpara pranë KLD-së.

2 ankesa të tjera të vitit 2016 janë verifikuar dhe rezultatet e tyre janë si vijon:

- i. 1 ankesë për mosrespektim formal të ligjit është arkivuar me arsyetimin se pretendimi është i pabazuar;
- ii. 1 ankesë, bazuar në raportin periodik të vetë kryetarit për mosdorëzimin në afat të vendimeve të arsyetuara, është arkivuar me arsyetimin se raportimi është i pasaktë.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Astrit Faqolli përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Pranë Komisionit nuk është paraqitur asnjë denoncim për këtë subjekt.

Për sa më sipër unë, Genta Tafa (Bungo), në cilësinë e relatores së çështjes, pasi hetova raportin e KLD-së, nuk gjeta indice apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit dhe propozoj për subjektin e rivlerësimit, z. Astrit Faqolli: “I aftë”.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 25.07.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES

Firdes SHULI

ANËTARRELATOR

Roland ILIAGenta Tafa (BUNGO)

Sekretare gjyqësore
Ina SERJANAJ